



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
ELBASAN**

**RAPORTI VJETOR MBI GJENDJEN E KRIMINALITETIT  
NË PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË ELBASAN  
PËR VITIN 2018**

## PASQYRA E LËNDËS

### I. Drejtimit dhe Përparësitë në Luftën kundër Kriminalitetit

1. Respektimi i të drejtave të njeriut  
Faqe 8
2. Të miturit dhe grupet vulnerabël, si të pandehur dhe viktima  
Faqe 10
3. Bashkëpunimi ndërinstytucional  
Faqe 15
4. Bashkëpunimi ndërkombëtar  
Faqe 16
5. Përdorimi i metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive  
Faqe 17
6. Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm  
Faqe 19
7. Informacion mbi Zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj  
Faqe 25
8. Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre  
Faqe 28
9. Informacion statistikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrajnë Funksione Publike  
Faqe 39
10. Të dhënat për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore apo të përbashkëta me Policinë e Shtetit  
Faqe 39
11. Problematikat e hasura  
Faqe 40

## **II. Analiza e treguesve të kriminalitetit dhe punës së Prokurorisë**

1. Volumi i punës në hetim	Faqe 41
1.1. Raporti i çështjeve të reja me të mbarturat dhe prurjet e tjera	Faqe 43
1.2. Puna e kryer në total	Faqe 44
1.3. Raporti i përfundimit të çështjeve dhe atyre të ngelura në hetim	Faqe 45
2. Çështje të përfaqësuara në gjykatë	Faqe 46
3. Treguesit kryesorë të punës së prokurorisë	Faqe 47
3.1. Procedimet penale mbetur në hetim	Faqe 48
3.2. Vendimet e mosfillimit	Faqe 51
3.3. Pushimet e çështjeve	Faqe 53
3.4. Kërkesat për pushim	Faqe 55
3.5. Vendimet e pezullimit	Faqe 56
3.6. Transferimet	Faqe 57

3.7.Çështje të dërguara në gjykim referuar numrit total të procedimeve të hetuara	Faqe 57
3.8. Disponimi në total për procedimet penale	Faqe 59
3.9.Disponimi në total për personat nën hetim dhe të pandehurit	Faqe 59
4. Të dhëna në lidhje me njoftimet për veprat penale	Faqe 60
5. Të dhënat në lidhje me masat e sigurimit personal e pasuror	Faqe 61
5.1. Masat e sigurimit shtrënguese dhe ndaluese	Faqe 61
5.2. Masat e sigurimit pasuror	Faqe 66
6. Treguesit e ekzekutimeve të vendimeve gjyqësore të formës së prerë	Faqe 66
7. Kriminaliteti sipas shtrirjes territoriale të njësive administrative në kompetencë të prokurorisë	Faqe 72
8. Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre	Faqe 75
9. Kriminaliteti sipas strukturës së Kodit Penal (krime – kundravajtje)	Faqe 84

### **III. Treguesit statistikorë 2 vjeçarë të veprave penale sipas strukturës së Kodit Penal**

	Faqe 85
1. Procedime penale të rregjistruara të reja	Faqe 85
2. Treguesit statistikorë pasqyruar në tabela për veprat penale	Faqe 86
<b>IV. Analiza e treguesve të efektivitetit të punës së prokurorisë</b>	
1. Treguesi i efektivitetit në gjykimin dhe në dënimin e të pandehurve	Faqe 154
1.1. Procedime penale të dërguara në gjyq	Faqe 154
1.2. Çështjet e ngelura për gjykim	Faqe 155
1.3. Pafajësitë	Faqe 157
1.4. Pushimet e çështjeve	Faqe 159
1.5. Tërheqje dhe kthim aktesh	Faqe 160
1.6. Ndryshim cilësimi ligjor të veprës penale	Faqe 161
1.7. Shfuqizimet e vendimeve	Faqe 162
2. Të dhëna për gjykimet e posaçme	Faqe 162
2.1. Kërkesat e prokurorit për gjykim të çështjes me marrëveshje	Faqe 163
2.2. Urdhëra penalë	Faqe 167

2.3. Kërkesa për gjykim	Faqe 169
2.4. Kërkesa për pushim	Faqe 169
3. Të dhëna mbi llojet dhe masat e dënimeve	Faqe 170
3.1. Të përgjithshme mbi llojet e dënimeve	Faqe 170
3.2. Llojet e dënimeve sipas grup veprave penale për vitin 2018	Faqe 172
3.3. Cilësia e hetimit	Faqe 173
3.4. Shpejtësia e Hetimit	Faqe 174
4. Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit	Faqe 175
5. Të dhëna për miturit në vitin 2018	Faqe 176
6. Të dhëna për pasojat e veprës penale	Faqe 181
6.1. Pasojat e veprave penale për të dëmtuarit e rritur	Faqe 181
6.2. Pasojat e veprave penale për të dëmtuarit e mitur	Faqe 182
<b>V. Të dhëna lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja</b>	

1. Ekstradime	Faqe 184
2. Letër porositë	Faqe 185
3. Njohjet e vendimeve penale	Faqe 185
4. Transferimet e procedimeve penale	Faqe 186
5. Shpalljet në kërkim ndërkombëtar, heqjet nga kërkimi ndërkombëtar	Faqe 186
<b>VI. Të dhëna për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore</b>	Faqe 186
<b>VII. Informacion mbi administrimin e prokurorisë</b>	Faqe 187
1. Organika	Faqe 187
2. Raporti financiar	Faqe 189
3. Çështje të tjera mbi administrimin e prokurorisë	Faqe 189
<b>VIII. Drejtimit dhe përparësitë në luftën kundër kriminalitetit për vitin pasardhës dhe rekomandime</b>	Faqe 191

# I. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT

## 1. Respektimi i të drejtave të njeriut

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në mbështetje të kuadrit ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar, pasur parasysh edhe praktikën e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, Kodin e Drejtësisë për të Mitur, akte të tjera ligjore e nënligjore, udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm (specifikojmë Udhëzimin e Përgjithshëm nr. 05 datë 26.10.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm etj.), ka synuar përgjatë vitit 2018, zbatimin uniform të dispozitave procedurale penale që lidhen me të pandehurit, viktimat dhe dëshmitarët e veprave penale.

Politika që ka ndjekur kjo prokurori për vitin 2018, ka pasur në fokus kryesor, viktimat vulnerabël, ato që pësojnë çënime në të drejtat dhe liritë e tyre, për shkak të gjinisë së tyre si dhe të miturit.

Si autoritet përgjegjës për garantimin e të drejtave të të pandehurve dhe të viktimës gjatë fazës së hetimeve paraprake, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore kanë treguar kujdes në njohjen e tyre, me të drejtat që ata gëzojnë, mbështetur në dispozitat procedurale penale dhe angazhimin pozitiv, për të mundësuar realizimin e këtyre të drejtave.

Viktimat dhe të pandehurit janë njohur me të drejtat e tyre, dhe në përfundim të hetimeve gjithashtu u është vënë në dispozicion kopje e akteve vendimmarrëse duke i bërë të ditur të drejtën e ankimit. Në rastet kur viktimat ka ndërruar jetë, janë bërë përpjekje për të gjetur dhe njoftuar trashëgimtarët e tyre.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, funksionon në një ndarje në seksione, sipas grup veprave penale që është vlerësuar të kenë në kompetencë lëndore hetimi, prokurorët e një seksioni të caktuar, mbështetur në përvojën dhe specializimin e tyre. Ndarja e prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në seksione, ka pasur për qëllim, specializimin e mëtejshëm të prokurorëve në fusha të caktuara, pasur parasysh edhe trajnimet e ndryshme që këta prokurorë marrin në këto fusha dhe përvojën profesionale të tyre. Kjo gjë është vlerësuar se është një faktor i rëndësishëm edhe në drejtim të njohjes së legjislacionit në mënyrë më të thelluar në fusha të caktuara dhe sjell pasoja drejtëpërdrejtë edhe në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut. Aktualisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, rezultojnë të jenë organizuar në 4 Seksione.

Ndarja e çështjeve me short, është realizuar duke u grupuar fillimisht materialet sipas seksioneve dhe më pas shpërndarja në short, mes prokurorëve të një seksioni të caktuar. Në mënyrë që të gjithë qytetarët të ndjehen të barabartë në ofrimin e shërbimeve nga prokuroria, është ndjekur në mënyrë rigorozë, shpërndarja e çështjeve të ardhura me short. Për këtë shkak me Udhëzimin nr. 32 prot datë 30.04.2018 „Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori dhe hedhjen e të dhënave në sistemin elektronik“ Drejtuesi i Prokurorisë ka udhëzuar mënyrat e monitorimit të procesit të



shpërndarjes së çështjeve me qëllim sigurimin e paanshmërisë, pavarësinë, efikasitetin e punës dhe disiplinimin e rasteve kur prokurori vendos refuzimin e marrjes së materialit. Ky udhëzim është mbështetur në Ligjin nr. 97/2016 datë 06.10.2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 96/2016 datë 06.10.2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Udhëzimin nr. 02 datë 29.12.2016 “Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimin nr. 03 datë 29.12.2016 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimin nr. 01 datë 20.02.2018 “Për krijimin e Seksioneve të Posaçme” të Prokurorit të Përgjithshëm, Urdhërit nr. 30 Prot. datë 30.04.2018 “Për krijimin e Seksionit të Posaçëm të Përkohshëm” të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, Urdhërit nr. 31 Prot. datë 30.04.2018 “Për organizimin dhe funksionimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan” të Drejtuesit të Prokurorisë.

Në rastet që qytetarët apo subjektet e tjera, kanë parashtruar kërkesa për zëvendësimin e prokurorit, apo edhe kur vetë prokurorët kanë parashtruar kërkesa për zëvendësimin e tyre, nga ushtrimi i ndjekjes penale në çështje të caktuara, nga Drejtuesi i kësaj prokurorie, është proceduar me marrjen e vendimeve përkatëse, në respektim të dispozitave procedurale penale, neni 16 e në vijim i Kodit të Procedurës Penale.

Përgjithësisht nga ana e viktimave apo edhe të pandehurve, të drejtat që janë ushtruar kanë pasur të bëjnë me kërkesat që i kanë drejtuar organit procedues për të marrë informacion në lidhje me procedimet penale ku janë të përfshirë si palë, për të kërkuar kryerje veprimesh hetimore shtesë e të tjera. Nga ana e prokurorëve është ndjekur praktika e dhënies përgjigje në mënyrë të vazhdueshme, kërkesave të parashtruara, duke u marrë edhe vendimet përkatëse mbi kërkesat e palëve.

Në respektim edhe të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, qytetarëve apo subjekteve të ndryshme, iu është dhënë përgjigje në mënyrë të vazhdueshme, kërkesave të tyre. Nga ana e ish Drejtuesit të kësaj prokurorie, që në vitin 2017, janë ndërmarrë masa, për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë, pasqyruar në Urdhërin nr. 1 datë 17.02.2017 „Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan“, sipas të cilit rezultojnë të jetë miratuar rregullorja përkatëse, e cila rezultojnë aktualisht të jetë në fuqi. Me Urdhërin nr. 02 datë 06.03.2017 „Për shërbimin e marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan“ nga ish Drejtuesi, është caktuar prokurori që drejton dhe mbikqyr shërbimin e marrëdhënieve me publikun si dhe nëpunësja e marrëdhënieve me publikun dhe koordinatorë në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit.

Në dhënien e informacioneve, sipas ligjit nr. 119/2014 „Për të drejtën e informimit“ është mbajtur parasysh ruajtja e sekretit hetimor apo atij shtetëror. Për realizimin e këtyre momenteve, ka qenë e rëndësishme koordinimi i punës mes zyrës së marrëdhënieve me publikun, me prokurorin e çështjes. Gjatë këtij procesi nga ana e kësaj prokurorie, janë respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut, duke ruajtur të dhënat personale, pasur parasysh të drejtën për jetë private. Sipas librit të korrespondencës për të drejtën e informimit, rezultojnë të jenë trajtuar 15 kërkesa, të kryera në mbështetje të këtij ligji, për vitin 2018.

Përsa i përket pretendimeve të ndryshme nga qytetarët në letra të shkruara prej tyre, përgjithësisht është ndjekur si procedurë, thirrja e qytetarëve në rastet kur prej tyre ka pasur pretendime për ekzistencën e ndonjë veprë penale, dhe marrja e kallzimit penal nga oficeri i policisë gjyqësore sipas grafikut të gatishmërisë, në ditët e ardhjes së letrës apo në rast ngarkese të këtij të fundit, kallzimi penal është marrë nga një oficer tjetër i policisë gjyqësore i kësaj prokurorie. Thirrja e qytetarëve për të parashtruar pretendimet e veta në formën e kallzimit kur kanë pasur pretendime për vepra penale, është bërë mbështetur në respektimin e dispozitave proceduriale penale, neni 283 e në vijim i Kodit të Procedurës Penale.

Në raste të tjera, që qytetarët mund të kenë pasur pretendime përsa i përket ecurisë së proceidmeve penale, nga Drejtuesi i Prokurorisë, janë studiuar dosjet, janë lënë udhëzime jo detyruese për prokurorët apo është diskutuar me ta mbi mbarëvajtjen e çështjes dhe qytetarët janë njoftuar në lidhje me vendimmarrjet përkatëse.

## **2. Të miturit dhe grupet vulnerabël, si të pandehur dhe viktima**

Siç u theksua edhe më sipër, politika që ka ndjekur kjo prokurori për vitin 2018, ka pasur në fokus kryesor, viktimat vulnerabël, ato që pësojnë çënime në të drejtat dhe liritë e tyre për shkak të gjinisë së tyre si dhe të miturit.

Mbështetur edhe në një analizë 6 (gjashtë) mujore, të kryer në lidhje me veprat penale me objekt dhunën me bazë gjinore, Urdhëri nr. 31 datë 30.04.2018 „Për organizimin dhe funksionimin e seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan“, pësoi ndryshime, duke u krijuar Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale kundër personit, krimeve kundër jetës, veprat penale me objekt dhunën me bazë gjinore etj. Këtij seksioni në hetimin e veprave penale me objekt dhunën me bazë gjinore, iu atashuan edhe 2 oficerët e policisë gjyqësore të Seksionit për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale me autorë apo të dëmtuar të mitur, duke pasur parasysh specializimin e tyre. Në këtë kuadër, me Udhëzimin nr. 50 prot datë 02.07.2018 „Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me çështjet penale që kanë si objekt dhunën me bazë gjinore“ Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, udhëzoi mbajtjen e të dhënave specifike statistikore që lidhen me këto vepra penale, sipas një table bashkangjitur udhëzimit. Mbajtja e këtyre të dhënave u vlerësua se do të ndihmojë, në analizimin e mëtejshëm të faktorëve që passjellin dhunën me bazë gjinore, me qëllim krijimin e politikave që do të mundësojë minimizimin e kësaj dhune.

Drejtuesja e kësaj prokurorie, përgjatë vitit 2018, mori pjesë në një trajnim të avancuar ndërkombëtar me fokus dhunën me bazë gjinore, me mbështetje të policisë Suedeze, SIDA dhe Kvinna till Kvinna. Njohuritë e përftuara në këtë drejtim, u mundua t'i zbatonte në organizimin dhe funksionimin e seksioneve pranë kësaj prokurorie dhe rritjen e bashkëpunimit të mëtejshëm me organizmat e ndryshëm shtetërorë, lokale, qendrore apo shoqatat jo fitim prurëse.

Në këtë kuadër, me qëllim respektimin e të drejtave të njeriut, ofrimin e kushteve sa më të përshtatshme në ambjentet e kësaj prokurorie, për realizimin e pyetjes/intervistimit të të miturve si dhe personave që kanë pësuar dhunë me bazë gjinore, është ardhur, një zyrë e cila gjendet në katin e parë të godinës së kësaj prokurorie. Nga ana e Drejtuesit u nxorr Udhëzimi nr. 51 Prot datë 02.07.2018 „Për përdorimin e zyrës për intervistimin e të miturve dhe të personave që kanë

*pësuar dhunë mbi bazë gjinore*“. Vendosja e kësaj zyre, në katin e parë të prokurorisë, u bë me qëllim për të distancuar viktimën e dhunës me bazë gjinore apo të miturin, nga përballja me ambientet e tjera të prokurorisë apo personat e ndryshëm që mund të gjenden në to, pasur parasysh vulnerabilitetin e tyre.

Janë lidhur përgjatë vitit 2018, dy marrëveshje, konkretisht me propozimet e Bashkisë së Belshit dhe Bashkisë së Gramshit, në mbështetje të VKM nr. 334 datë 17.02.2011 „*Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij*“. Marrëveshjet të cilat mbajnë datat 20.06.2018 (me Bashkinë Gramsh) dhe 17.07.2018 (me Bashkinë Belsh) kanë palë nënshkruese edhe subjekte të tjera siç është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, Komisaritetet përkatëse të policisë, Zyrën e Përmbarrimit Elbasan, institucionet shëndetësore, arsimore, zyrën e punësimit, shoqatën „*Forumi i gruas*“ Elbasan, dhe prefektin.

Objekti i këtyre marrëveshjeve është koordinimi i punës dhe bashkëpunimi midis institucioneve, për të adresuar rastet e dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje, përmes një mekanizmi referimi.

Me Urdhërin nr. 53 prot datë 05.07.2018 „*Për caktimin e personit të kontaktit për komunikimet me organizmat e ndryshme në lidhje me rastet e dhunës me bazë gjinore si dhe të specialistit që do të jetë pjesë e Ekipit Teknik Ndërdisciplinor*“ nga ana e Drejtuesit të kësaj prokurorie, mbështetur në VKM nr. 334 datë 17.02.2011 „*Për mekanizmin e bashkërendimit të punës për referimin e rasteve të dhunës në marrëdhëniet familjare dhe mënyrën e procedimit të tij*“, në kuadër edhe të marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura si më sipër, është caktuar si person kontakti të cilit i drejtohen të gjitha komunikimet qofshin me gojë apo të shkruara, si elektronike ashtu edhe të shtypura, si dhe përgjegjës për dhënien rrugë përgjigjeve të nevojshme, Drejtuesi i Seksionit për hetimin dhe përfaqësimin e veprave penale me objekt dhunën me bazë gjinore i cili ndihmohet nga Zyra e Rregjistrimit, ashtu edhe caktimin e një prokurori të këtij seksioni në Ekipin Teknik Ndërdisciplinor.

Në këtë kuadër, pasur parasysh edhe të miturit, si persona vulnerabël, funksionon edhe Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale me autorë të mitur apo të dëmtuar të mitur. Me Udhëzimin nr. 46 prot datë 20.06.2018 „*Për mbajtjen e të dhënave statistikore*“ Drejtuesi i kësaj Prokurorie, ka udhëzuar mbajtjen e të dhënave statistikore me tregues të posaçëm për veprat penale ku të dëmtuar apo autorë janë të miturit, duke i bashkangjitur këtij udhëzimi edhe një tabelë përkatëse për mbajtjen e këtyre të dhënave.

Konceptimi i funksionimit të këtyre seksioneve, është në një bashkërendim të punës ndërmjet njëri – tjetrit, duke i atashuar Seksionit për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale kundër dhunës me bazë gjinore, dy oficerët e policisë gjyqësore pjesë e Seksionit për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale me autorë të mitur apo të dëmtuar të mitur.

Me një memo, datë 21.06.2018, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, iu kërkua Shkollës së Magjistraturës të përfshinte në kuadrin e Programit të Trajnimit Vazhdues për prokurorët dhe gjyqtarët, tema që i përkasin dhunës me bazë gjinore. Propozimi ynë, ashtu si

edhe i institucioneve të tjera apo edhe vetë vlerësimit që ka bërë kjo shkollë, është marrë parasysh duke u bërë pjesë e programit të trajnimit vazhdues, tema të kësaj fushe.

Përgjatë kësaj kohe, prokurorët e këtyre dy seksioneve kanë qenë pjesë e trajnimeve me temë dhunën me bazë gjinore dhe për të miturit në konflikt me ligjin apo viktime të dhunës, jo vetëm në kuadër të Programit të Trajnimit vazhdues për prokurorët dhe gjyqtarët, por edhe të trajnimeve dhe takimeve të realizuara nga agjentë të tjerë. Mund të përmendim ndër to, trajnimin e datës 24 – 25 korrik 2018, të organizuar nga shoqata „*Forumi i Gruas*“ Elbasan, trajnimi i datës 26.10.2018 i organizuar nga Qendra e Shërbimeve të Integruara Ligjore dhe praktike, Save the Children, Të ndryshëm por të Barabartë, trajnimi i datës 20.12.2018 i organizuar nga Prefekti i Elbasanit dhe shoqata „*Tjetër Vizion*“ etj.

Ndër synimet për vitin në vijim, përta i përket këtij momenti, pra të miturve dhe grupeve vulnerabël, mbajmë parasysh në zbatim edhe të Udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm, punësimin e një koordinatori për viktimat.


Me shkresën nr. 2467/1 prot datë 24.04.2018 Prokurori i Përgjithshëm ka përcjellë shkresën nr. 256 prot datë 13.09.2018 të Zyrës së Urdhërit të Psikologut ku janë përcaktuar emrat e psikologëve të cilët kanë marrë trajnim të posaçëm në funksion të përmbushjes së detyrimeve që rrjedhin nga Ligji nr. 37/2017 “*Kodi i Drejtësisë Penale për të mitur*”. Për qarkun e Elbasanit, janë caktuar dy psikologe vlerësuese dhe asistuese dhe dy psikologe asistuese. Pasur parasysh numrin e çështjeve, ku përveç pranisë së detyrueshme në rastet me të dëmtuar apo autorë të mitur, vlerësohet prania e psikologut edhe në çështjet e dhunës me bazë gjinore, si dhe shtrirjes territoriale që ka qarku i Elbasanit, do të ishte me vend rritja e numrit të psikologëve.

Puna që kryen kjo prokurori, në drejtim të respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive të tyre, ka si fokus kryesor shmangien e riviktimizimit apo viktimizimit të përsëritur dhe bashkërendimin me gjithë aktorët e tjerë, me qëllim sigurimin e mundësive viktimave për të venë në vend të drejtat e tyre dhe për t’u rehabilituar.

**Fotografi të Zyrës për Miturit dhe Viktimave të Dhunës me Bazë Gjinore:**







### 3. Bashkëpunimi ndërinstitucional

Përveç sa u citua në pikën 2, të këtij kapitulli, pra bashkëpunimi me aktorë të ndryshëm përsa i përket luftës ndaj dhunës me bazë gjinore, apo sigurimin e të drejtave më të përforcuara ndaj të miturve, duhet të theksojmë specifikisht bashkëpunimin me institucione të ndryshme, agjensi të ndryshme ligjzbatuese.

Bashkëpunimi me policinë e shtetit, është një bashkëpunim, që ka një rol kryesor dhe domethënës në luftën ndaj kriminalitetit. Përgjithësisht është pikërisht policia e shtetit, që gjendet e para në vendngjarje, që referon materialet në prokurori dhe gjithashtu nën drejtimin dhe udhëzimet e prokurorit, kryen hetime. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, bashkëpunimi me Drejtorinë e Policisë Vendore Elbasan si dhe me Komisaritatet përkatëse të shtrira në gjithë territorin ku kjo prokurori ushtron kompetencën territoriale, ka qenë i ngushtë, për t'u vlerësuar dhe përgjithësisht frytdhënës. Janë kryer analiza të përbashkëta, me përfaqësues të policisë së shtetit, jo vetëm të qarkut por edhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, për çështje të natyrës së veçantë (pra referuar procedimeve penale konkrete) apo edhe të natyrës së përgjithshme (ritjen e bashkëpunimit, në drejtim të zbardhjes së ngjarjeve, shkëmbimit të informacionit sa më shpejt dhe në mënyrë sa më frutdhënëse, mundësitë që u ofrohen oficerëve të policisë së shtetit për trajnim) etj. Në bashkëpunim me Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, është analizuar mundësia dhe ka nisur puna për studimin e dosjeve të pezulluara ndër vite, me qëllim rifillimin e tyre, pa u plotësuar afatet e parashkrimit, për të shfrytëzuar të gjitha planet hetimore, që mund të bëhen të realizueshme sot për shkak të mundësive të shfrytëzimit të mjeteve të reja të kërkimit të provës. Në lidhje me hetimin e

krimeve të rënda, vlerësojmë punën e policisë së shtetit, të kryer në këtë drejtim, gjë që ka sjellë rifillimin e 6 (gjashtë) procedimeve penale, të cilat janë në ndjekje.

Esktradime të personave në kërkim nga autoritet e huaja, janë realizuar 5 të tilla, për 5 të dënuar.

Bashkëpunim gjithashtu për t'u vlerësuar është me të gjitha forcat e tjera të policisë së shtetit, si me policinë e burgjeve, Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në Burgje apo Shërbimin e Kontrollit të Brendshëm në policinë e Shtetit.

Në krahasim me vitin e kaluar, përgjatë vitit 2018, ka pasur 1737 kallzime nga policia e shtetit, apo ndryshe 494 referime më shumë. Gjithashtu referuar ngjarjeve, konstatohet se ka pasur në vitin 2018, 972 ngjarje, apo 207 ngjarje më shumë se vitin e kaluar.

Drejtoria e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Burgje, ka referuar 42 materiale, Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Drejtorinë Vendore të Policisë Elbasan, ka referuar 7 raste.

Praktika e ndjekur ndër vite e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, është përgjithësisht urdhërimi për kryerjen e veprimeve hetimore, oficerët e policisë gjyqësore që e kanë referuar, duke iu përcjellë me shkresë materialin, institucionit përkatës (pra policisë së shtetit, SHÇBA, SHKBB etj. Gjithashtu me qëllim kryerjen e hetimeve në mënyrë më efektive, sa më të shpejtë apo kur ka pasur çështje të komplikuar, janë urdhëruar për kryerje të veprimeve hetimore edhe oficerët e policisë gjyqësore të seksioneve të kësaj prokurorie.

Institucione të tjera ligjzbatuese me të cilat kjo prokurori ka pasur bashkëpunim të ngushtë, është Shërbimi Informativ i Shtetit, ndërkohë që nuk ka munguar bashkëpunimi edhe me Kontrollin e Lartë të Shtetit i cili ka bërë 3 kallzime penale, organet tatimore të cilat kanë bërë 11 referime veprash penale, organet doganore të cilat kanë referuar vetëm 1 material.

Në punën e tyre, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, shfrytëzojnë në maksimum bashkëpunimin me agjensitë e tjera ligjzbatuese, me institucionet e ndryshme shtetërore, siç janë për t'u theksuar Drejtoria e Parandalimit të Patsimit të Parave, Zyrat e Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Inspektoriatet përkatëse të Mjedisit, të Ndërtimit, ALUIZNI, Ministrinë përkatëse etj.

#### **4. Bashkëpunimi ndërkombëtar**

Përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar, konstatohet se ekziston një bashkëpunim i frytshëm, specifikisht nga pala shqiptare në drejtim të kërkesave për ndihmë juridike të sjella nga shtetet e huaja.

Rezulton të jenë kryer 5 ekstradime, për personat në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet e huaja.

**Letër porosi nga jashtë shtetit** ka pasur gjithsej 46, nga të cilat rezulton të jenë ekzekutuar 17, të kenë qenë të pamunduara për t'u ekzekutuar pavarësisht veprimeve të prokurorit dhe gjykatës 8



të tilla, dhe në fazë ekzekutimi rezultojnë të jenë 21 kërkesa. Më specifikisht sipas objektit letër porositë nga jashtë shtetit i pasqyrojmë si vijon:

***Letër porosi të dërguara nga prokurët e kësaj prokurorie***, në drejtim të shteteve të huaja, rezulton të jenë 21 të tilla, kryesisht për veprat penale si më poshtë vijon:

- 9 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike;
- 7 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër jetës dhe personit;
- 5 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi krime kundër autoritetit të shtetit;

***Kërkesa për njohje vendimesh penale të huaja*** rezulton të kenë qenë 6 të tilla.

Ndërkohë rezulton që nga ana e prokurorisë sonë të jetë bërë 1 kërkesë për ekstradim të një të dënuari, kërkesë e drejtuar autoriteteve greke, e cila është refuzuar nga këto të fundit, me arsyetimin se personi e ka kryer veprën penale në shtetin grek. Atëherë nga prokuroria jonë është proceduar me kërkesë për njohjen e vendimit penal shqiptar të dënimit në shtetin grek.

Gjithashtu bashkëpunimi me autoritet e huaja është shfaqur edhe në drejtim të transferimit të procedimeve penale prej tyre dhe të rregjistruara në prokurorinë tonë si dhe shpalljeve në kërkim ndërkombëtar.

## ***5. Përdorimi i metodave speciale hetimore dhe hetimet proaktive***

Nga prokurorët e kësaj prokurorie rezultojnë të jenë rregjistruar kryesisht 5 procedime penale. Konkretisht veprat penale për të cilat janë kryer rregjistrimet e procedimeve penale janë 3 në fushën e korrupsionit dhe abuzimit me detyrën, 1 për vepra penale kundër drejtësisë dhe 1 për veprat penale në sferën ekonomike. Gjatë trajtimit të parashtruar në këtë raport, i gjeni sipas dispozitave penale përkatëse të rregjistruara.

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, mbahet rregjistri i posaçëm ku rregjistrohen të dhënat për përgjimet, sipas treguesve të rregjistrimit.

Nga të dhënat e deritanishme rezultojnë se janë rregjistruar 92 vendime lejim përgjimi referuar edhe të dhënave të marra në gjykatë, nga të cilat:

- 65 përgjime telefonike dhe
- 27 përgjime ambjentale.

Ndërkohë rezulton se janë miratuar 69 kërkesa për zgjatje përgjimi nga gjykata ndërkohë që 1 kërkesë për zgjatje vendimi të përgjimit është refuzuar.

Megjithëse ka rezultuar që hetimet për procedimet penale në të cilat janë përdorur këto mjete të kërkimit të provës, kanë qenë duke u kryer edhe për më tepër se një vepër penale, rezulton se përgjimet telefonike janë kryer më shumë për krime kundër jetës dhe vepra penale të kryera me

dashje kundër shëndetit, pasndjekur nga veprat penale që lidhen me korrupsionin, shpërdorimin e detyrës dhe pastrimin e produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale. Ndërkohë përgjimet ambjentale, janë kryer më tepër për vepra penale që lidhen me korrupsionin, pasndjekur nga vepra penale në fushën e lëndëve narkotike dhe kundër jetës dhe shëndetit.

Në një ndarje në vija të përgjithshme rezulton se përgjimet janë kërkuar për këto vepra penale:

#### ***Përgjimet telefonike:***

- 35 përgjime telefonike për ***krime kundër jetës dhe vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit*** (21 përgjime telefonike për nenin 78 të K.Penal, si dhe 2 zgjatje; 2 përgjime telefonike për nenin 76 të K.Penal; 2 përgjime telefonike për nenin 99 të K.Penal; 10 përgjime telefonike për nenin 79/dh të K.Penal, si dhe 42 zgjatje;
- 25 përgjime telefonike për veprat penale që lidhen me ***korupsionin, shpërdorimin e detyrës dhe pastrimin e parave*** (4 përgjime telefonike për nenin 287 të K.Penal; 6 përgjime telefonike për nenin 248 të K.Penal, si dhe 2 zgjatje; 14 përgjime telefonike për n. 259 të K.Penal (çëshjet kanë qenë të rregjistruara edhe për vepra penale të tjera si psh. N. 88 i K.Penal, n. 244 e 248 i K.Penal, por për mos rënë në përsëritje është cituar vetëm një nga veprat penale) si dhe 31 zgjatje; 1 përgjim telefonik për nenin 245 të K.Penal (si dhe 1 zgjatje).
- 2 përgjime telefonike për veprat penale në ***fushën e falsifikimit të monedhave dhe letrave me vlerë*** (neni 183/2 të K.Penal);
- 1 përgjim telefonik ***për vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore*** (neni 298 i K.Penal, si dhe 1 zgjatje);
- 1 përgjim telefonik për ***krime seksuale*** (neni 108/a/2 të K.Penal);
- 1 përgjim telefonik ***për vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit*** (neni 113, 114 të K.Penal, si dhe 1 zgjatje);

#### ***Përgjimet ambjentale:***

- 10 përgjime ambjentale në veprat penale që lidhen ***me korrupsionin*** (9 përgjime ambjentale për nenin 259 të K.Penal (në 1 çështje rezulton se janë kryer hetime edhe për n. 245 të K.Penal) si dhe 1 zgjatje; 1 përgjim ambjental për nenin 245 të K.Penal, si dhe 1 zgjatje);
- 6 përgjime ambjentale në ***fushën e lëndëve narkotike*** (5 përgjime ambjentale për nenin 283 të K.Penal; 1 përgjim ambjental për nenin 284 të K.Penal;)

- 6 përgjime ambjentale *për veprat penale kundër jetës apo shendetit të personit* (3 përgjime ambjentale për nenin 76 të K.Penal; 1 përgjim ambjental për nenin 99 të K.Penal; 2 përgjime ambjentale për nenin 78 të K.Penal);
- 2 përgjime ambjentale për vepra penale *në fushën e falsifikimit të monedhave apo letrave me vlerë* (neni 183/2 të K.Penal);
- 1 përgjim ambjental *krime seksuale* (për nenin 108/a/2 të K.Penal);
- 1 përgjim ambjental për vepra penale *kundër sekretit apo kufijve shtetërore* (neni 298 i K.Penal);
- 1 përgjim ambjental për vepra penale *kundër rendit dhe sigurisë publike* (neni 278 të K.Penal);

*Veprime simuluese* rezultojnë të jenë përdorur në 2 raste:

- 1 në fushën e krimit ekonomik, për nenin 183/2 të K.Penal;
- 1 për veprat penale në fushën e lëndëve narkotike, për nenin 283 të K.Penal.

Nga prokurorët janë respektuar kërkesat, kushtet dhe kriteret e kërkuara nga ligji.

## **6. Informacion mbi zbatimin e Udhëzimeve të Përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm**

Udhëzimi nr. 1 datë 20.02.2018 „Për krijimin e seksioneve të posaçme“ në Prokurorinë për Krime të Rënda dhe në Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Durrës, Elbasan, Vlorë, Fier, Shkodër, Lezhë, Korçë e Gjirokastër për hetimin e veprave penale sipas kompetencave të përcaktuara në atë udhëzim, i nxjerrë në kuadrin e zbatimit të Marrëveshjes nr. 413 prot e nr. 937 prot. Datë 02.02.2018 ndërmjet Prokurorit të Përgjithshëm dhe Ministrit të Brendshëm, si dhe në funksion të planit të veprimit për luftën kundër krimit të organizuar.

Mbështetur në Udhëzimin e sipërcituar, si dhe në shkresën nr. 1001/6 Prot datë 20.04.2018 të Prokurorit të Përgjithshëm, mbi emrat e prokurorëve prej të cilëve Drejtuesi i Prokurorisë do të përzgjedhë prokurorët që do të caktohen në Seksionin e Posaçëm, Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka nxjerrë Urdhërin nr. 30 Prot datë 30.04.2018 „Për Krijimin e Seksionit të Posaçëm të përkohshëm „Për luftën kundër krimit të organizuar, trafikut të narkotikëve, korrupsionit, veprat penale në sferën ekonomike, veprat penale të kryera nga subjektet e posaçme“, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan. Në përbërje të këtij Seksioni u caktuan tre prokurorë, njëri prej të cilëve, e konkretisht Zëvendës Drejtuesi i kësaj prokurorie, u caktua edhe Drejtuesi i Seksionit të Posaçëm. Në këtë urdhër u përcaktuan detyrat konkrete, siç është raportimi i të dhënave statistikore tek prokurori/koordinator në Prokurorinë e Përgjithshme nga Drejtuesi i Seksionit brenda 10 ditëve; bashkëpunimi me shërbimet e policisë gjyqësore pranë Task Forcës Speciale Qendrore, Task Forcës Speciale Rajonale për shkëmbimin e informacionit, për kryerjen e analizave dhe vlerësimeve të

përbashkëta rreth grupeve kriminale si dhe realizimin e veprimtarisë hetimore në zbatim të detyrave specifike, të përcaktuara në Planin e Veprimit Kundër Krimin të Organizuar, Operacioni „*Forca e Ligjit*“; kompetenca lëndore e Seksionit të Posaçëm të Përkohshëm; mënyra e shpërndarjes së çështjeve në këtë seksion, mbështetur në ligjin nr. 97/2016 „*Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë*“ dhe Udhëzimit nr. 03 datë 29.12.2016 „*Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori*“ të Prokurorit të Përgjithshëm.

Me Udhëzimin nr. 55 prot datë 10.09.2018 „*Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me çështjet penale në fushën e korrupsionit, pastrimit të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*“ nga ana e Drejtuesit të kësaj prokurorie, është udhëzuar mbajtja e të dhënave statistikore me tregues të veçantë, duke i bashkangjitur edhe një tabelë përkatëse.

Përpara krijimit të seksionit të sipërcituar, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka qenë ngritur Seksioni për hetimin e veprave penale në fushën e shpërdorimit të detyrës, korrupsionit dhe pastrimit të parave e produkteve të veprës penale.

Përsa i përket burimeve të referimit të materialeve hetimore apo kallëzimeve penale rezulton se pjesa kryesore e materialeve hetimore është referuar nga shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan. Pjesa tjetër e procedimeve penale është nisur mbi bazën e të dhënave të sjella nga SHISH, referimet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve Tiranë, Drejtoria e Hetimit Tatimor, SHÇBA, si dhe nga kallëzimet e shtetasve të bëra në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Elbasan.

Gjatë vitit 2018, nga prokurorët e këtij seksioni, është kërkuar në 14 raste masa sigurimit „*arrest në burg*“, në 1 rast „*arrest në shtëpi*“ dhe në 6 raste „*detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*“, ndërsa nga gjykata është vendosur në 13 raste masa sigurimit „*arrest në burg*“, në 2 raste „*arrest në shtëpi*“ dhe në 6 raste „*detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore*“.

Gjatë vitit 2018, nga prokurorët e këtij seksioni, është kërkuar në gjykatë, dërgimi i çështjes për gjykim për 11 procedime, me 28 të pandehur, prej të cilëve 9 persona kanë qenë të arrestuar. Nga gjykata në seancë paraprake është vendosur pranimi i kërkesave të prokurorisë për 11 procedime, ndërsa në lidhje me të pandehurit nuk është pranuar kjo kërkesë për 7 të pandehur, raste për të cilat është bërë dhe ankim në gjykatën e apelit.

Gjatë vitit 2018, në lidhje me çështjet e përfaqësuara nga prokurorët e këtij seksioni, kanë përfunduar gjykimet në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan për 11 procedime penale me 13 të pandehur, prej të cilëve 3 të arrestuar. Në lidhje me të pandehurit e gjykuar rezulton se për 9 të pandehur është proceduar me gjykim të shkurtuar dhe për 4 të pandehur është proceduar me gjykim të zakonshëm.

Në lidhje me kërkesat e prokurorëve për llojin e masat e dënimit, rezulton se janë kërkuar dënime me gjobë për 2 të pandehur, dënime me burgim për 3 të pandehur, zbatim i neneve 59 e 63 të K.Penal për 6 të pandehur dhe dënime plotësuese për 3 të pandehur, pezullimi i gjykimet për 1 të pandehur, tërheqja e akteve për 1 procedim me 3 të pandehur. Në lidhje me dënimet e dhëna nga gjykata për të pandehurit rezulton se janë dhënë dënime me gjobë për 2 të pandehur, dënime me burgim për 3 të pandehur, zbatim i neneve 59 e 63 të K.Penal për 6 të pandehur dhe dënime

plotësuese për 3 të pandehur, pezullimi i gjyqimit për 1 të pandehur, kthim aktesh për 1 procedim me 3 të pandehur si dhe pafajësi për 1 të pandehur.

Sa u përket të dhënave mbi të pandehurit, një pjesë e tyre kanë kryer detyra shtetërore, ndërsa pjesa tjetër janë subjekte të përgjithshëm si dhe persona juridikë.

Kërkesa për kontrolle të vendeve të kërkuara nga prokurorët e këtij seksioni dhe të vendosura nga gjykata gjatë vitit 2018 është bërë vetëm për 1 rast.

Në lidhje me fushën e marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, nga prokurorët e seksionit janë hartuar 7 letërporosi për marrjen e provave jashte shtetit.

Gjatë periudhës së funksionimit të seksionit të përkohshëm të posaçëm në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, janë realizuar takime dhe mbajtur kontakte të vazhdueshme me drejtuesit e institucioneve dhe organeve të tjera ligjzbatuese, me qëllim rritjen e bashkëpunimit dhe identifikimin e saktë të rasteve që kanë shërbyer si bazë për nisjen e procedimeve penale. Kontakte të vazhdueshme janë mbajtur me shërbimet e policisë gjyqësore të Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan dhe të SHÇBA, me të cilët ndiqet dhe numri më i madh i procedimeve penale. Marrëdhënie mjaft të frutshme e pozitive ka pasur me institucionin e SHISH.

Krijimi i Seksionit të Posaçëm, passolli edhe ndryshime të mëtejshme në organizimin dhe funksionimin e Seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, duke u riorganizuar edhe një herë seksionet e kësaj prokurorie. Për këtë shkak me Urdhërin nr. 31 Prot datë 30.04.2018 Drejtuesi i kësaj prokurorie, urdhëroi krijimin e seksioneve në varësi të objektit të punës së tyre, referuar kategorive të veprave penale. Për shkak të ndryshimeve të ndodhura në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ky urdhër ka pësuar ndryshime dhe aktualisht organizimi në këtë prokurori, është në këtë mënyrë:

1. Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale kundër personit dhe krimeve kundër jetës, kundër pavarësisë dhe rendit kushtetues, kundër veprave penale me objekt dhunën me bazë gjinore, kundër drejtësisë etj, në përbërje të të cilit janë caktuar 4 prokurorë dhe 1 oficer i policisë gjyqësore i seksionit.
2. Seksioni i Posaçëm i Përkohshëm sipas udhëzimit të sipërcituar të Prokurorit të Përgjithshëm, në përbërje të të cilit janë caktuar 3 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve;
3. Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike si dhe kundër autoritetit të shtetit, në përbërje të të cilit aktualisht janë 9 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve;
4. Seksioni për hetimin dhe gjykimin e veprave penale me të pandehur dhe viktimë të mitur si dhe për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë, në përbërje të të cilit aktualisht janë 4 prokurorë dhe 2 oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve.

Me Udhëzimin nr. 48 prot datë 02.07.2018 „Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me çështjet penale në fushën e narkotikëve“ Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së

Parë Elbasan, ka udhëzuar sipas një tablele me tregues statistikore mbajtjen e të dhënave të veçanta të treguesve që lidhen me këto vepra penale.

Me Urdhërin nr. 63 prot datë 17.10.2018 „Për caktimin e prokurorit në Komisionin për asgjësimin e bimëve/lëndëve narkotike“ Drejtuesi i kësaj prokurorie, në mbështetje edhe të Udhëzimit të Përbashkët nr. 2487 datë 15.05.2017 „Për trajtimin e bimëve, lëndëve narkotike apo psikotrope dhe prekursorëve kimike të sekuestruara“ ka urdhëruar caktimin e një prokurori në këtë komision.

Nga informacioni i realizuar nga prokurori i caktuar në këtë komision, rezulton se më datë 20.12.2018, është mbledhur grupi i punës dhe po në këtë datë është bërë asgjësimi i lëndëve narkotike, të cilat ishin të magazinuara në magazinat e Ministrisë së Brendshme në Lundër. Sasia e lëndës narkotike ishte pjesë e provave materiale të sekuestruara për llogari të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Elbasan.

Sasia që është asgjësuar është:

Cannabis sativa e ambalazhuar:	382.354 kg;
Cannabis Sattiva e pa ambalazhuar:	148.005 kg;
Fara Cannabisi:	2.391 gr;
Heroinë e ambalazhuar:	6.55 gr;
Heroinë e paambalazhuar:	590.946 gr;
Kokainë e paambalazhuar:	12.999 gr.

Veprimi i asgjësimit është bërë me diegie, në përdorim të lëndës djegëse benzinë dhe në prani të të gjithë anëtarëve të komisionit dhe tëpunonjësve të policisë. Veprimi i marrjes nga magazina në Lundër, transportimi dhe deri në asgjësimin e lëndëve narkotike është bërë nën shoqërimin e forcave të policisë dhe forcave të posaçme operationale të Ministrisë së Brendshme. Veprimi i marrjes nga magazina dhe asgjësimi i tyre është shoqëruar me fotografi të bëra nga eksperti kriminalist i Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Me Udhëzimin nr. 56 prot datë 10.09.2018 „Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me veprat penale të „Falsifikimit të dokumentave dhe letrave me vlerë“ Drejtuesi i kësaj prokurorie, gjithashtu ka udhëzuar mbajtjen e të dhënave statistikore të veçanta, duke i bashkangjitur edhe një formular me treguesit përkatës udhëzimit.

Ndërkohë, pasur parasysh se një pjesë e çështjeve duke qenë se kanë qenë nën hetim apo nuk rezulton të jenë referuar nga Forca e ligjit e policisë së shtetit, janë ndjekur nga prokurorët sipas seksioneve të ndara në grup vepra penale.

Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 4 datë 26.10.2018 „Për përgjimet“, i Prokurorit të Përgjithshëm. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, mbahet rregjistri i posaçëm ku rregjistrohen të dhënat për përgjimet, sipas treguesve të rregjistrimit (shih pikën 5 Kapitulli I).

Udhëzimi i përgjithshëm nr. 3 datë 26.10.2018 „Për vlerësimin, administrimin dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar „Sekret Shtetëror“. Aktualisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së

Shkallës së Parë Elbasan, mbahet rregjistri i posaçëm në të cilin rregjistrohet materialet e klasifikuara si sekret shtetëror. Ky rregjistër mbahet nga Drejtuesi i Seksionit të Posaçëm të krijuar si më sipër. Për vitin 2018 rezulton se janë rregjistruar 16 shkresa të ardhura nga agjensitë ligjzbatuese. Nga prokurorët, oficerët e policisë gjyqësore apo punonjës të administratës, gjithmonë janë mbajtur parasysh parashikimet ligjore për ruajtjen e informacionit të klasifikuar „*Sekret Shtetëror*“ si dhe për ruajtjen e sekretit hetimor.

Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 5 datë 26.10.2018 „*Për garantimin e asistencës ndaj viktimave dhe dëshmitarëve të veprave penale*“. Në lidhje me këtë udhëzim janë pasqyruar të dhënat në pjesën e mësipërme të këtij raporti (shih pikën 1 dhe 2 të Kreut I).

Udhëzimi i Përgjithshëm nr. 6 datë 20.11.2018 „*Për hetimin pasuror, sekuestrimin dhe konfiskimin e produkteve të veprës penale*“. Në lidhje me pasuritë e sekuestruara dhe konfiskuara në procesin penal për periudhën e cituar, është kërkuar vendosja e masës së sigurimit pasuror e sekuestros preventive në kuadër të hetimeve të procedimit penal nr. 318 të vitit 2018 për pasuritë e mëposhtme:

- 1) Pasuria e llojit apartament, pranë ZVRPP Elbasan;
- 2) Pasuria sipërfaqe 5200 m<sup>2</sup>, pranë ZVRPP Elbasan;
- 3) Pasuria e llojit njësi, me sipërfaqe 144 m<sup>2</sup>, pranë ZVRPP Elbasan;
- 4) Pasuria lloji i pasurisë Njësi, sipërfaqja totale 48,2 m<sup>2</sup>, pranë ZVRPP Elbasan;
- 5) Pasuria pranë ZVRPP Elbasan.
- 6) 100% të kuotave të zotëruara nga në 1 shoqëri tregtare.

Kërkesa e organit të Prokurorisë është pranuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan. Procedimi penal gjendet në fazën e hetimeve paraprake, po ashtu pasuritë vazhdojnë të jenë të sekuestruara.

Në lidhje me referimet e hetimeve pasurore në zbatim të ligjit nr. 10 192 datë 03.12.2009 „*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*“, konstatohet se nga ana e prokurorëve të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Elbasan, është proceduar vetëm në një rast përcjellja e informacionit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Për Krime të Rënda Tiranë, e konkretisht ai në lidhje me procedimin penal nr. 425 të vitit 2016. Ndërkohë në lidhje me procedimet penale nr. 1259 e vitit 2018, nr. 1306 i vitit 2018, të rregjistruar për veprën penale të „*Pastrimit të produkteve të veprës penale dhe veprimtarisë kriminale*“ parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, nuk janë referuar rastet tek Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, pas ardhjes në djeni se ndërkohë kjo prokurori është duke kryer hetim pasuror për rastet në fjalë.

Me fillimin e vitit 2019, do të merren masa të menjëhershme, për nxjerrjen e të dhënave dhe raportimet përkatëse në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

Pasur parasysh Udhëzimet e mëparshme të Prokurorit të Përgjithshëm, për organizimin, funksionimin dhe mbarëvajtjen e punëve në prokurori, nga Drejtuesit e kësaj prokurorie, janë ndërmarrë një sërë aktesh për zbatimin e tyre, pasqyruar si vijon:

1. Me Urdhërin nr. 1 datë 17.02.2017 „Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan“, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar miratimin e rregullores përkatëse, e cila rezulton aktualisht të jetë në fuqi.
2. Me Urdhërin nr. 02 datë 06.03.2017 „Për shërbimin e marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan“ është urdhëruar caktimi i prokurorit që drejton dhe mbikqyr shërbimin e marrëdhënieve me publikun si dhe nëpunësja e marrëdhënieve me publikun dhe koordinatorë në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit.
3. Me udhëzimin nr. 4 datë 12.01.2018 „Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori, lidhur me ecurinë e procedimeve penale“ Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka parashikuar mënyrën e kërkimit të informacionit për ecurinë e çdo procedimi penal nga prokurorët e seksioneve si dhe drejtuesi i seksionit respektiv, detyrimin e prokurorëve të informojnë drejtuesin e seksionit dhe drejtuesin e prokurorisë sa herë që kërkohet nga këta të fundit në lidhje me ecurinë e njëçështje të caktuar si në fazën e hetimeve paraprake, për vendimmarrjen dhe për probleme të tjera që mund të lindin gjatë procedimit, gjatë gjykimit tëçështjeve në themel, gjykimit tëçështjeve të veçanta (kundërshtim vendim mosfillimi) dhe në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale.
4. Me Udhëzimin nr. 9 datë 25.01.2018 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka ndërmarrë masa për disiplinimin e mënyrës për formimin e fashikujve të gjykimit dhe të prokurorit në përfundim të hetimeve, krijimin e një praktike të njehsuar për mënyrën e renditjes së akteve për të gjitha procedimet në hetim, sigurimin e respektimit të parimeve të një procesi të drejtëm, të barbartë dhe të rregullt ligjor.
5. Është nxjerrë urdhëri nr. 31 Prot datë 30.04.2018 „Për organizimin dhe funksionimin e Seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së shkallës së Parë Elbasan“ i cili në periudha të ndryshme ka pësuar ndryshime, për shkak të lëvizjeve në organikë që ka pasur kjo prokurori.
6. Me Udhëzimin nr. 32 prot datë 30.04.2018 „Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori dhe hedhjen e të dhënave në sistemin elektronik“ Drejtuesi i Prokurorisë ka udhëzuar mënyrat e monitorimit të procesit të shpërndarjes sëçështjeve me qëllim sigurimin e paanshmërisë, pavarësinë dhe efektivitetin e punës dhe disiplinimin e rasteve kur prokurori vendos refuzimin e marrjes së materialit.
7. Me Udhëzimin nr. 33 prot datë 30.04.2018 „Për respektimin e standarteve të etikës, rregullat e sjelljes dhe disiplinës në punë“ nga Drejtuesi i Prokurorisë, me qëllim



disiplinimin e monitorimit, respektimit të orarit të punës dhe qëndrimit në detyrë si dhe respektimin e rregullave të etikës, janë nxjerrë disa udhëzime specifike.

8. Me Udhëzimin nr. 65 prot datë 29.10.2018 „Për sistemin e provave materiale“ Drejtuesi i Prokurorisë ka ngritur një grup pune për sistemin e provave materiale, me qëllim identifikimin e tyre në mënyrë sa më të shpejtë e të rregullt, pasur parasysh që Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në fund të vitit 2017 është transferuar në një godinë të re dhe administron edhe arkivën apo materiale të Prokurorisë që tashmë nuk janë më si ajo e Librazhdit apo Gramshit.

Gjatë vitit 2019, ka vazhduar nxjerrja e udhëzimeve të ndryshme, si për administrimin e provave materiale, për mbajtjen e të dhënave për çështjet që kanë të bëjnë me marrëdhëniet juridiksionale me jashtë, për pasqyrimin në kohë në regjistrat përkatës të të dhënave të kërkuara nga ligji, për procedurën e administrimit të vendimeve gjyqësore, për mbarëvajtjen e punës në prokurori në lidhje me administrimin e hyrje – daljeve në ambjentet e institucionit, për krijimin dhe përbërjen e komisionit disiplinor në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan etj.

Përsa i përket marrëdhënieve Drejtues – Prokurorë, nga ana e Drejtuesve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, janë mbajtur një sërë aktesh si akte konstatimi në rastet kur prokurori tashmë ka marrë vendim për përfundim hetimesh dhe udhëzime jo detyruese për kryerje veprimesh hetimore.

Në lidhje me mbledhjen e informacionit për procedimet penale në fazën e hetimeve paraprake janë nxjerrë urdhërat përkatës, gjatë vitit 2018, për kërkim informacioni për çështje të veçanta.

Pra siç vërehet më lart, nga ana e Drejtuesve të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, është proceduar në vijimësi me nxjerrjen e urdhërave për organizimin dhe strukturën organike, pasur parasysh edhe treguesit e ushtrimit të ndjekjes penale dhe të kriminalitetit.

Ndarja në seksione është bërë referuar problematikës që ka qarku i Elbasanit, përsa i përket kriminalitetit, specializimit të prokurorëve, krijimit të mundësive për shpërndarjen e drejtë të çështjeve dhe kryerjes së punës me efikasitet dhe efijencë.

## **7. Informacion mbi zbatimin e Rezolutës së Kuvendit dhe Planit të Veprimit në zbatim të saj**

Siç është pasqyruar më lart, rastet e hetimeve të filluara kryesisht nga prokurorët, mbeten të ulëta. Ky fakt lidhet shpesh me punën e policisë gjyqësore, e cila referon menjëherë materialin sapo merr dijeni për kryerjen e veprës penale. Në rastet kur prokurorët kanë konstatuar vetë fakte penale nuk kanë hezituuar të fillojnë çështje kryesisht, çështje të cilat janë regjistruar kryesisht pasi është marrë informacion nga media apo kanë rezultuar fakte të reja në lidhje me vepra të tjera penale, gjatë hetimeve të çështjeve në ndjekje. Mendojmë se në këtë rast, rol të rëndësishëm do të luante, ekzistenca e një punonjësi që do të kishte për detyrë të informohej vazhdimisht nëpërmjet ndjekjes së informacioneve që ofrohen në media, punonjës që duhet të jetë pjesë e zyrës së marrëdhënieve me publikun.

Veprimet simuluese, mbeten të pakta për qarkun e Elbasanit. Veprimet simuluese kërkojnë angazhim dhe nga struktura të tjera të policisë së shtetit, përveç atyre vendore, për shkak se në vende të vogla, policia gjyqësore e ka të pamundur realizimin e veprimeve simuluese për shkak të njohjes së tyre prej qytetarëve si dhe qytetarët jo në çdo rast tregohen bashkëpunues.

Përsa i përket bashkëpunimit me organet e ndryshme në kuadrin e rivlerësimit kalimtar të prokurorëve, nga ana e kësaj prokurorie nuk ka munguar gatishmëria për kthimin e përgjigjeve dhe vënien në dispozicion të materialeve të kërkuara.

Bashkëpunimi me policinë gjyqësore dhe agjensitë e tjera ligjzbatuese në kuadrin e shkëmbimit të informacionit vlerësohet se ka qenë shumë i mirë, kryesisht me policinë e shtetit dhe SHISH, efektiv dhe me pasoja pozitive.

Përsa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar me agjensitë e huaja ligjzbatuese me qëllim luftën ndaj krimit të organizuar dhe veprave penale që lidhen me pastrimin e parave, është konstatuar se specifikisht në çështjet e pastrimit të parave, në kompetencën lëndore dhe territoriale të kësaj prokurorie, ka pasur zvarritje për shkak të ekzekutimit me vonesë nga autoritetet e huaja të letërporosive të dërguara prej prokurorëve, apo jo në mënyrë të plotë. Për këtë shkak është rritur edhe më shumë bashkëpunimi me policinë e shtetit, kryesisht me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, me qëllim shfrytëzimin e të gjitha kanaleve të mundshme ndërkombëtare për mbledhjen e informacionit sa më shpejt dhe në mënyrë sa më të frutshme.

Në lidhje me ashpërsimin e politikës penale, përsa i përket masave të sigurisë dhe dënimit kundër korrupsionit, dhunës në familje, krimeve kundër jetës, pastrimit të parave, krimit ekonomik dhe financiar, armëmbajtjes pa leje, recidivistëve, krimit mjedisor, nga ana e prokurorëve të kësaj prokurorie, bëhen përpjekje për ashpërsimin e tyre, pasqyruar kryesisht në masat e sigurimit të kërkuara. Megjithatë në këtë drejtim ka ende shumë punë për t'u bërë.

Përsa i përket krimit mjedisor, prokuroria e Elbasanit ka bërë përpjekje të mëdha për të zbardhur faktet penale, por është konstatuar se nuk gjendet e njëjta frymë bashkëpunimi nga aktorët e tjerë siç janë inspektoriatet përkatëse të mjedisit apo ato për mbrojtjen e pyjeve.


Në vazhdimësi të këtij raporti do të gjeni të dhëna më të hollësishme për politikën penale, ndërkohë që në këtë pikë, vlerësojmë të ndalojmë, në pasqyrimin e disa të dhënave më të detajuara, në lidhje me veprën penale të **dhunës në familje** jepen disa të dhëna të detajuara:

Neni 130/a i K.Penal:


- Mosfilluar 6 çështje;
- Mbartur 29 çështje, me 22 të pandehur, me 5 të arrestuar;
- Rregjistruar 87 çështje, me 23 persona nën hetim, 52 të pandehur, 31 të arrestuar;
- Pushuar 11 çështje, me 8 persona nën hetim, 1 i arrestuar;
- Pezulluar 1 çështje;
- Transferuar 2 çështje, me 2 persona nën hetim;
- Dërguar gjyqit 71 çështje, me 74 të pandehur, 30 të arrestuar;
- Mbetur në hetim 31 çështje, me 13 persona nën hetim, 5 të arrestuar;

- Gjykuar 63 çështje, me 68 të pandehur (6 çështje me gjykim të zakonshëm dhe 57 çështje me gjykim të shkurtuar)
- Prokurori ka kërkuar dënimin me burgim në minimum për 37 të pandehur, dënim me burgim mesatar për 5 të pandehur, dënim me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal për 26 të pandehur;
- Gjykata ka vendosur dënimin me burgim me minimum për 36 të pandehur, dënimin mesatar për 4 të pandehur, dënimin me burgim dhe zbatimin e nenit 59 të K.Penal për 26 të pandehur, në 1 rast ka vendosur kthimin e akteve dhe në 1 rast pushimin e çështjes.


**Disponimi në përqindje i çështjeve në lidhje me dhunën në familje:**



**Masat e dënimit kërkuar nga prokurori:**



**Masat e dënimit dhënë nga gjykata**



Përsa i përket masave të sigurimit, rezulton se:


- Janë kryer arrestime në flagrancë në 43 raste, për të cilat prokurori ka kërkuar vleftësimin si të ligjshëm;

- Për 36 raste prokurori ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit „arrest në burg“ parashikuar nga gjykata dhe kjo e dhënë në 34 raste;
- Për 6 raste prokurori ka kërkuar „Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore“ parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe gjykata e ka dhënë në 8 raste;
- Për 1 rast prokurori ka kërkuar masë ndaluese dhe gjykata e ka dhënë në 1 rast.

Në përqindje kërkesat e prokurorit dhe vendimet e gjykatës rezultojnë si më poshtë:

**Masat e sigurimit kërkuar nga prokurori:**

**Masat e sigurimit dhënë nga gjykata**



Përsa i përket politikës penale më të butë ndaj të miturve, grave, personave me aftësi të kufizuara, që akuzohen për kryerjen e veprave penale me rrezikshmëri të ulët shoqërore, zhvillimin e hetimeve më të shpejta, mendojmë se këtë vit, janë bërë përpjekje për t'u vlerësuar. Më poshtë, në këtë raport mund të gjeni të dhënat e ofruara për të miturit dhe për të pandehurat e gjinisë femër.

Bashkëpunimi me institucionet e ndryshme si Ministria e Drejtësisë, ka qenë frytdhënës dhe shumë i ngushtë, ndërkohë që edhe me institucionet e tjera si Kontrolli i Lartë i Shtetit, ILDKPKI, nuk ka munguar bashkëpunimi.

Në vijim të këtij raporti do të gjendi të dhëna më të hollësishme përsa i përket urdhërave penale, marrëveshjeve të fajësisë, gjyqimit të drejtëpërdrejtë, përpjekjet e bëra nga prokurorët, për t'i shërbyer shpejtësisë së procesit, dhe qëllimit të ligjit penal.

## **8. Informacion mbi zbatimin e rekomandimeve të Këshillit të Ministrave dhe udhëzimeve të Prokurorit të Përgjithshëm të nxjerra në bazë të tyre**

Me VKM nr. 203 datë 11.04.2018 “Për miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2018”, Këshilli i Ministrave ka vendosur miratimin e rekomandimeve prioritare për Prokurorin e Përgjithshëm, në luftën kundër kriminalitetit, për vitin 2018.

Përsa më poshtë parashtrojmë hapat e ndërmarra mbi zbatimin e rekomandimeve prioritare nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan.

### ***Garantimi i pavarësisë së prokurorit:***

Në lidhje me marrjen e masave për respektimin e standarteve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve, siç theksuam edhe më sipër, prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e ushtrojnë funksionin e tyre të ndarë në seksione, sipas grup veprave penale. Në krye të secilit seksion është Drejtuesi i Seksionit, i cili ndihmon Drejtuesin në detyrën e tij, në lidhje me respektimine këtyre standarteve.

Prokurorët, gëzojnë pavarësinë në çështjet penale konkrete, por në respektim të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, dispozitave proceduriale penale, mbi bazë të ankesave të qytetarëve apo kompleksiteteve që paraqesin çështjet, ndërmerren hapat për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështjet penale si dhe të grupeve hetimore. Respektohet vendimmarrja e prokurorit, duke u përpjekur pavarësisht volumit të madh të punës, që të jepen udhëzime të cituara më lart, para kësaj vendimmarrje. Jemi të hapur ndaj çdo kërkesë të publikut, që lidhet me etikën dhe anën profesionale të prokurorëve, duke i dhënë përgjigje dhe ndërmarrë masat e duhura.

Prokurorët zëvendësohen vetëm në respektim të kriterëve dhe kushteve që përcakton ligji procedural penal.

Nga Drejtuesi i Prokurorisë është nxjerrë udhëzimi nr. 33 prot datë 30.04.2018 “Për respektimin e standarteve të etikës, rregullat e sjelljes dhe disiplinës në punë” që ka si objekt, disiplinimin e monitorimit të respektimit të orarit të punës, qëndrimin në detyrësi dhe respektimi i rregullave të etikës.

Në lidhje me marrjen e masave për rritjen profesionale dhe specializimin e prokurorëve për njohje dhe zbatim të legjislacionit penal për të miturit, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, është krijuar Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale me autorë të mitur apo të dëmtuar të mitur. Prokurorëve të seksionit, iu është bërë me dije se duhet të aplikojnë në programin e trajnimit vazhdues të Shkollës së Magjistraturës, për tema trajnimi që kanë lidhje pikërisht me çështje ku viktime apo i pandehuri është i mitur. Prej tyre janë ndërmarrë hapa konkrete duke u bërë pjesë e këtyre trajnimeve. Theksojmë se Shkolla e Magjistraturës kërkon aplikimet individualisht nga prokurorët dhe për këtë shkak, nga Drejtuesi janë udhëzuar në cilat trajnime duhet të fokusohen për shkak të pjesëmarrjes në seksionet përkatëse të kësaj prokurorie. Në rastin kur agjensi të tjera dërgojnë ftesa që lidhen me çështje të kësaj natyre, propozohen fillimisht të shkojnë prokurorët apo oficerët e policisë gjyqësore të caktuar pikërisht në seksionin përkatës dhe në rast pamundësie objektive të tyre, shkojnë prokurorët apo oficerët e tjerë të policisë gjyqësore.

Përsa i përket marrjes së masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, bëjmë me dije se, janë regjistruar kryesisht 5 procedime penale (shih pikën 5 të kreut I).

Në lidhje me zbatimin e teknikave speciale të hetimit, konstatojmë se metoda speciale e hetimit, mjete i kërkimit të provës, përgjimi është përdorur në shumë raste të cilat i gjeni të sipërcituara në pikën 5 të kreut I ashtu si edhe veprimet simuluese në disa raste që i gjeni në të njëjtën pikë të këtij kreu.

Në lidhje me përdorimin e sistemit elektronik CAMS, është përdorur vazhdimisht për shpërndarjen e çështjeve me short elektronik, ndërkohë që është nxjerrë nga Drejtuesi i Prokurorisë udhëzimi nr. 32 prot datë 30.04.2018 “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori dhe hedhjen e të dhënave në sistemin elektronik”, në mënyrë që të zgjidhen problematikat në mënyrën e shpërndarjes së çështjeve, kalimin e materialeve nga një seksion në tjetrin, refuzimin e çështjeve nga prokurorët, duke pasur parasysh zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore.


### ***Lufta kundër korrupsionit***

Me Urdhërin nr. 30 prot datë 30.04.2018, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, është urdhëruar në zbatim edhe të Udhëzimit nr. 01 datë 20.02.2018 “Për krijimin e Seksioneve të Posaçme” të Prokurorit të Përgjithshëm, krijimi i Seksionit të Posaçëm të Përkohshëm me objekt hetimin e veprave penale, ku ndër të tjera të korrupsionit, krimin ekonomik etj. Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ky Seksion është drejtuar përgjatë vitit 2018, nga Zëvendës Drejtuesi i kësaj prokurorie. Megjithatë siç u theksua edhe më lart, këto lloj veprash penale, në rastin kur janë konstatuar gjatë procedimeve penale të regjistruara për vepra penale që ndiqen nga prokurorë jashtë këtij seksioni dhe për të cilat kryesisht janë ndërmarrë veprime hetimi, veprimet janë kryer nga i njëjti prokuror që ka pasur çështjen bazë me qëllim ruajtjen e sekretit hetimor dhe sigurimin e pavarësisë së prokurorit.


Më poshtë parashtrijmë në mënyrë të detajuar çështjet e mosfilluara, regjistruara në fushën e korrupsionit, shpërdorimit të detyrës, fshehjes së të ardhurave, krime në fushën e doganave, dhe pastrimit të produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale dhe disponimi për to:

- Neni 171 – 179/ç të K.Penal – Mosfilluar 2 çështje; Mbartur nga viti i kaluar 3 çështje, me 1 person nën hetim dhe 1 të pandehur; Rregjistruar 9 çështje me 2 persona nën hetim; Pushuar 2 çështje, Pezulluar 1 çështje; Dërguar për gjykim 3 çështje me 3 të pandehur; Nga prokurori është kërkuar dënimi në 2 raste, 1 dënim me burgim me minimum dhe në 1 rast dënimin me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal dhe gjykata ka vendosur në të njëjtën mënyrë.
- Neni 180 – 182/a të K.Penal - Mosfilluar 10 çështje; Mbartur nga viti i kaluar 5 çështje, me 1 person nën hetim, 2 të pandehur; Rregjistruar 17 çështje, me 1 person nën hetim; Pushuar 1 çështje; Transferuar 1 çështje, me 1 person nën hetim; Dërguar gjyqit 2 çështje me 2 të pandehur; Nga prokurori është kërkuar dënimi për 7 të pandehur, 4 prej të cilëve dënim me gjobë, 1 dënim me burgim mesatar, 2 dënim me burgim dhe zbatimin e nenit 59 të K.Penal; Gjykata ka vendosur në 2 raste dënimin me gjobë, 1 dënim me burgim mesatar, në 2 raste dënim me burgim dhe zbatimin e nenit 59 të K.Penal; në 2 raste ka dhënë pafajësi;

**Disponimi në tërësi për nenet 171 – 179/ç dhe 180 – 182/a të K.Penal:**



- Nenet 183 – 185 të K.Penal – Të mbartura nga vitet e kaluara – 9 çështje, me 1 person nën hetim, 6 të pandehur; Rregjistruar 5 çështje, me 2 të pandehur; Pushuar 1 çështje me 1 person nën hetim; Pezulluar 5 çështje; Dërguar gjyqit 7 çështje, me 8 të pandehur; Nga prokurori është kërkuar dënimi për 6 të pandehur, nga të cilët për 2 është kërkuar dënimi me burgim në minimum, për 3 është kërkuar dënimi me burgim mesatar, për 1 është kërkuar dënimi me burgim dhe aplikimi i nenit 59 të K.Penal dhe nga gjykata është vendosur në 5 raste dënimi me burgim në minimum dhe në 1 rast dënimi me burgim dhe aplikimi i nenit 59 të K.Penal;




- Neni 244 i K.Penal - Rregjistruar 2 procedime penale, me 3 persona nën hetim. Vazhdojnë të jenë aktualisht në hetim;
- Neni 245/1 i K.Penal - Mosfilluar 1 procedim penal; mbartur nga viti i kaluar 3 çështje penale, me 3 të pandehur; Rregjistruar 6 procedime penale, me 1 person nën hetim, 4 të pandehur; Pushuar 1 çështje; Dërguar për gjykim 5 çështje, me 7 të pandehur; Dënuar 9

të pandehur, për 1 të pandehur është vendosur kthimi i akteve; Nga prokurori është kërkuar në 4 raste dënim në minimum; në 1 rast dënim mesatar, në 5 raste zbatimi i nenit 59 të K.Penal kurse gjykata ka vendosur në 4 raste dënim në minimum; në 1 rast dënim mesatar, në 4 raste zbatimi i nenit 59 të K.Penal dhe në 1 rast kthimi i akteve;


- Neni 248 i K.Penal - Mosfilluar 29 çështje; Mbartur nga viti i kaluar 48 çështje me 5 persona nën hetim dhe 16 të pandehur; Rregjistruar 56 çështje me 1 person nën hetim; Rifilluar nga të pezulluara 2 çështje; Ardhur me transferim 2 çështje; Pushuar 38 çështje me 6 persona nën hetim; Pezulluar 1 çështje; Transferuar 2 çështje; Dërguar për gjykim 3 çështje, me 16 të pandehur; Dënuar 6 të pandehur; Prokuroria ka kërkuar në 1 rast dënim me gjobë, në 1 rast dënim me burgim në minimum, në 1 rast dënim me burgim mesatar, në 5 raste dënim me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal; Gjykata ka vendosur në 1 rast dënim me gjobë, në 5 raste dënimin me burgim duke aplikuar n. 59 të K.Penal, në 2 raste ka vendosur pafajësi;
- Neni 257/a i K.Penal - Mbartur nga vitet e kaluara 1 çështje, me 1 të pandehur; Dërguar për gjykim 1 çështje me 1 të pandehur; Prokurori ka kërkuar dhe gjykata ka vendosur dënim me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal;
- Neni 258 i K.Penal – Rregjistruar 1 çështje, e cila vazhdon të jetë në hetim;
- Neni 259 i K.Penal – Mbartur nga viti i kaluar 4 çështje, me 2 persona nën hetim; Rregjistruar 5 çështje me 5 persona nën hetim; Pushuar 3 çështje me 2 persona nën hetim;
- Neni 287 i K.Penal – Mbartur nga vitet e kaluara 31 çështje, me 1 person nën hetim e 6 të pandehur; Rregjistruar 22 çështje, Rifilluar nga të pezulluarat 3 çështje, Pushuar 16 çështje me 1 person nën hetim; Pezulluar 5 çështje; Transferuar 1 çështje; Dërguar për gjykim 2 çështje, me 6 të pandehur, 4 të arrestuar; Nga prokurori për 1 të pandehur është kërkuar dënimi me minimum kurse nga gjykata është vendosur pafajësi.
- Neni 287/b i K.Penal – Rregjistruar 1 çështje me 1 të pandehur e cila është pushuar.

**Veprat penale të korrupsionit, abuzimit me detyrën dhe pastrimin e parave në total:**







**Dënimet e kërkuara nga prokurori  
për nenet 171 – 179/ç; 180 – 182/a:**



**Dënimet e dhëna nga gjykata  
për nenet 171-179/ç; 180/182/a:**




**Dënimet e kërkuara nga prokurori dhe vendimet e gjykatës për nenet 183 – 185 të K.Penal:**



**Dënimet e kërkuara nga prokurori**

**Dënimet e dhëna nga gjykata**


**për korrupsion, abuzim me detyrën, pastrim parash:**




Në lidhje me masat e sigurimit, konstatohet se:

- Neni 171 – 179/ç të K.Penal – Në 1 rast është proceduar me arrestim në flagrancë, nga prokurori është kërkuar vleftësimi si i ligjshëm dhe caktimi i masës së sigurimit “*Detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, dhe gjykata ka vendosur të njëjtën masë sigurimi.
- Neni 183 – 185 të K.Penal – Është kryer 1 arrest në flagrancë nga policia gjyqësore; prokurori ka kërkuar vleftësimin si të ligjshëm dhe caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale dhe kjo kërkesë është miratuar nga gjykata;
- Neni 244 i K.Penal – Është kryer 1 arrestim në flagrancë nga policia gjyqësore, nga prokurori është kërkuar vleftësimi si i ligjshëm i arrestimit dhe caktimi i masës së sigurimit “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, kërkesë kjo e pranuar nga gjykata;
- Neni 245/1 i K.Penal – është urdhëruar ndalimi i 1 personi nga prokurori; është kërkuar në gjykatë vlerësimi si i ligjshëm për 1 urdhër ndalimi të prokurorit; janë kërkuar në gjykatë caktimi i 7 masave të sigurimit “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale dhe nga gjykata është vendosur në 5 raste caktimi i masës së sigurimit “*arrest në burg*” n. 238 i K.Pr.Penale dhe në 2 raste caktimi i masës së sigurimit “*detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale;
- Neni 259 i K.Penal – Është lëshuar 1 urdhër ndalimi nga prokurori; është kërkuar në gjykatë vleftësimi si i ligjshëm i urdhërit të ndalimit, është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale për 7 raste, është vendosur nga gjykata caktimi i masës së sigurimit “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, për 5 raste dhe në 2 raste është vendosur caktimi i masës së sigurimit “*detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale;

### **Kërkesat e prokurorit për caktimin e masave të sigurimit**



### Vendimet e gjykatës për caktimin e masave të sigurimit



Nga Drejtuesi i Prokurorise, jane nxjerre disa udhezime per mbajtjen e te dhenave statistikore, specifikuar në pikën 5 të kreut I.


### *Lufta kundër krimit të organizuar*

Në lidhje me procedimet penale në fushën e lëndëve narkotike, armëmbajtjes, apo veprave penale kundër personit (ngjarjet e rënda kriminale të ndodhura në Elbasan që kanë cënuar apo rrezikuar jetën e personit) i parashtrajmë sa më poshtë:

- Nenet 76 – 79/c të K.Penal – Të mbartura nga vitet e kaluara 8 çështje, me 1 person nën hetim, 3 të pandehur; Rregjistruar të reja 21 çështje, me 9 persona nën hetim; Rifilluar nga të pezulluarat 4 çështje; Pushuar 2, me 1 person nën hetim; Pezulluar 2, Dërguar për gjykim 3, me 3 të pandehur; Nga prokurori është kërkuar dënimi për 5 të pandehur, për të cilët 5 me dënim me burgim mesatar, Nga gjykata është dhënë 1 dënim me burgim në minimum, 3 me dënim me burgim mesatar; 1 është dhënë pafajësi;
- Neni 88 i K.Penal – Mbartur 1 çështje me 1 të pandehur; Rregjistruar 3 çështje me 2 persona nën hetim; Pushuar 1 çështje; Dërguar për gjykim 1 çështje me 1 të pandehur; Dënuar 3 të pandehur, për të cilët prokurori ka kërkuar në 2 raste dënimin me burgim në


minimum, në 1 rast dënimin me burgim dhe aplikimin e n. 59 të K.Penal, ndërkohë që gjykata ka vendosur në 1 rast dënimin me burgim në minimum, në 1 rast dënimin me burgim në minimum dhe në 2 raste dënimin me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal;

**Disponimi i çështjeve si më sipër në përqindje, për veprat penale kundër jetës dhe shëndetit:**




**Dënimet e kërkuara nga prokurori**

**Vendimet e gjykatës**




- Neni 141/a i K.Penal – Mosfilluar 1 çështje penale; Mbartur nga viti i kaluar 4 çështje; Rregjistruar 3 çështje; Rifilluar nga të pezulluarat 1 çështje; Pushuar 1 çështje; Pezulluar 2 çështje; Transferuar 4 çështje;
- Nenet 278 – 280 të K.Penal – Mosfilluar 11 çështje penale; Mbartur nga viti i kaluar 20 çështje, me 1 person nën hetim, me 9 të pandehur; Rregjistruar 54 çështje penale, me 19 persona nën hetim, me 17 të pandehur, Rifilluar nga të pezulluarat 2 çështje e rregjistruar për Armëmbajtje pa leje dhe heqje e paligjshme e lirisë; Pushuar 16 çështje, me 9 persona nën hetim; pezulluar 12 çështje; Dërguar për gjykim 22 çështje, me 26 persona nën hetim; Prokurori ka kërkuar dënimin për 21 të pandehur nga të cilët për 4 dënimin me gjobë; për 8 të pandehur dënimin me burgim në minimum; për 8 të pandehur dënimin me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal si dhe pushimin e çështjes për 1 të pandehur; Gjykata ka vendosur dënimin me gjobë për 5 të pandehur, dënimin me burgim në minimum për 7 të pandehur; dënimin me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal për 8 të pandehur, pushimin e çështjes për 1 të pandehur;


**Disponimi i çështjeve për nenet 278 - 280të Kodit Penal, në përqindje:**



**Dënimet e kërkuara nga prokurori**




**Vendimet e gjykatës**




- Nenet 283 – 286 të K.Penal – Mosfilluar 1 çështje penale; Mbartur nga viti i kaluar 47 çështje penale, me 16 persona nën hetim, me 17 të pandehur; Rregjistruar 91 çështje, me 34 persona nën hetim; 14 të pandehur; Pushuar 20 çështje, me 22 persona nën hetim; Pezulluar 31 çështje (çështja penale bazë si praktikë në këtë prokurori është ndjekur në këtë mënyrë: për të pandehurin dërgohet për gjykim ndërkohë që për personin që mund të ketë siguruar lëndën narkotike të pandehurit ndahet çështja dhe pas kryerjes së veprimeve të nevojshme hetimore, pezullohet); Transferuar 1 çështje; Dërguar gjyqit 24 çështje penale, me 31 të pandehur; Prokurori ka kërkuar dënimin e 29 të pandehurve, nga të cilët 19 dënim me burgim në minimum; 4 dënim me burgim mesatar, 6 dënim me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal, në 1 rast pushimin e çështjes; Gjykata ka vendosur në 16 raste dënimin me burgim në minimum; në 4 raste dënimin me burgim mesatar; në 8 raste dënimin me burgim dhe aplikimin e nenit 59 të K.Penal; në 2 raste pushimin e çështjes.


**Disponimi i çështjeve për nenet 283 - 286të Kodit Penal, në përqindje:**



### Dënimet e kërkuara nga prokurori



### Vendimet e gjykatës




Në lidhje me masat e sigurimit, konstatohet se:

- Neni 76 – 79/c të K.Penal - Në 5 raste janë kryer arrestime në flagrancë; nga prokurori është kërkuar në 5 raste vleftësimi si i ligjshëm, dhe caktimi i masës së sigurimit “*arrest me burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale për 5 rastet, kërkesa këto të miratuara nga gjykata;
- Neni 88 i K.Penal - Në 4 raste janë kryer arrestime në flagrancë, nga prokurori është kërkuar në 4 raste kërkesa për vleftësim të ligjshëm, caktimi i masës së sigurimit është kërkuar në 1 rast “*arrest në burg me afat*” parashikuar nga neni 245/ç i K.Pr.Penale dhe në 3 raste caktimi i masës së sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale dhe po në këtë mënyrë ka vendosur edhe gjykata;
- Neni 278 – 280 i K.Penal – Janë kryer 24 arrestime në flagrancë nga policia gjyqësore; në gjykatë është kërkuar vleftësimi si i ligjshëm për 24 rastet e arrestimit, janë kërkuar caktimi i masave të sigurimit “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale për 13 raste, për 1 rast është caktimi i masës së sigurimit “*arrest me burg me afat*” parashikuar nga neni 245/ç i K.Pr.Penale; për 8 raste është kërkuar caktimi i masës së sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, në 1 rast është kërkuar caktimi i masës ndaluese; Gjykata ka vendosur në 12 raste caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, në 9 raste caktimin e masës së sigurimit “*Detyrim për t’u paraqitur në*


*policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, në 1 rast është vendosur caktimi i masës ndaluese;

- Neni 283 – 286 të K.Pr.Penale – Janë kryer 38 arrestime në flagrancë nga policia gjyqësore; prokurori ka kërkuar vleftësimin si të ligjshëm për 38 raste, caktimin e masës së sigurimit për 38 raste, nga të cilat në 23 raste ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale, në 6 raste ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “*arrest në burg me afat*” parashikuar nga neni 245/ç i K.Pr.Penale; në 8 raste ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit “*detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale, në 1 rast ka kërkuar caktimin e masës së sigurimit ndaluese; nga gjykata është vendosur në 23 raste caktimi i masës së sigurimit “*arrest në burg*” parashikuar nga neni 238 i K.Pr.Penale; në 6 raste caktimi i masës së sigurimit “*arrest në brug me afat*” parashikuar nga neni 245/ç i K.Pr.Penale; në 8 raste caktimi i masës së sigurimit “*detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore*” parashikuar nga neni 234 i K.Pr.Penale; në 1 rast është vendosur caktimi i masës ndaluese.

**Masat e kërkuara nga prokurori**



**Masat e dhëna nga gjykata**



Nga Drejtuesi i Prokurorisë është nxjerre udhezimi me nr. 48 prot. Date 02.07.2018 “*Për mbajtjen e të dhënave statistikore në lidhje me çështjet penale në fushën e narkotikeve*”.

### **9. Informacion stasikor mbi çështjet penale që lidhen me procesin e verifikimit të Integritetit të Personave që Zgjidhen, Emërohen ose Ushtrajnë Funkione Publike**

Nuk raportohen nga zyra e regjistrimit, raste të referuara në vitin 2018, në zbatim të ligjit nr. 138/2015 „*Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrajnë funksione publike*“ me qëllim sigurimin e pastërtisë së figurës së punonjësve publikë.

Ndërkohë nuk ka munguar bashkëpunimi i institucionit tonë me Prokurorinë e Përgjithshme për kthimin e përgjigjeve, vënien në dispozicion të materiale apo me institucione të tjera, për rastet kur janë kërkuar të dhëna për verifikimin e integritetit të personave si më sipër cituar.

### **10. Të dhënat për temat dhe numrin e trajnimeve të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore apo të përbashkëta me Policinë e Shtetit**

Ju lutem për këtë pjesë shihni tabelat bashkangjitur këtij raporti.

## 11. Problematikat e hasura

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, referuar ligjeve dhe akteve nënligjore në fuqi, udhëzimeve të përgjithshme të Prokurorit të Përgjithshëm, Udhëzimeve të Drejtuesit të Prokurorisë, konstatohet se jo në çdo rast zbatohen nga prokurorët e kësaj prokurorie udhëzimet.

Kryesisht ato udhëzime që në pjesën dërrmuese nuk janë zbatuar kanë të bëjnë pikërisht me raportimin e të dhënave statistikore. Kjo vjen edhe si pasojë e ngarkesës në punën e tyre në ushtrim të funksioneve sipas Kodit të Procedurës Penale dhe Kushtetutës.

Për këtë arsye, në këtë raportim jemi munduar të pasqyrojmë në mënyrë më të plotë të gjitha të dhënat e grumbulluara pas një konsultimi me të gjithë prokurorët. Arsyet që prokurorët nuk kanë raportuar të dhënat për përgjimet në kohën e duhur, ka pasur të bëjë me faktin se janë konsideruar materiale sekrete. Gjithashtu e njëjta situatë është konstatuar edhe në disa raste të rifillimit të çështjeve të pezulluara.

Ndërkohë përsa i përket përdorimit të sistemit CAMS, përveç përdorimit të rregullt të tij për hedhjen e shortit elektronik, prokurorët jo në çdo rast e kanë të mundur pasqyrojnë hedhjen e të dhënave në sistem. Së pari për shkak të ngarkesës së tyre në punë, hedhja e të dhënave në sistem, përsa kohë prokurorët nuk asistohen personalisht nga sekretare apo oficerë të policisë gjyqësore, pasur parasysh ngadalesinë me të cilën punon ky sistem, është e vështirë për prokurorët të tregohen efektivë si në hetim, përfaqësim në gjykatë dhe hedhjen e të dhënave në sistem; Së dyti: Sistemi nuk është i azhornuar me ndryshimet e reja të K.Pr.Penale; Së treti: hedhja në short e materialeve, nëpërmjet sistemit elektronik, konstatohet se nuk bën një ndarje pothuajse të barabartë të punës ndërmjet prokurorëve dhe për këtë shkak shpesh herë Drejtuesi i Prokurorisë detyrohet të përjashtojë prokurorë të caktuar nga shorti, me urdhër.




## II. ANALIZA E TREGUESVE TË KRIMINALITETIT DHE PUNËS SË PROKURORISË

### 1. Volumi i punës në hetim (procedimet e mbartura, procedimet e reja të rregjistruar (edhe K.P.Ushtarak), procedimet e rifilluara dhe mosfillimet)

Përgjatë vitit 2018, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka punuar me 4 086<sup>1</sup> materiale.

- Procedime penale, janë **3 192** materiale
- Materiale kallzuese janë **894** materiale.




Përgjatë vitit 2017, vihet re ky raport i procedimeve penale dhe materialeve kallzuese.



Krahasimi ndërmjet dy viteve, ngarkesa e kësaj prokurorie, për tërësinë e materialeve të trajtuara, megjithëse në shifra, tregon për një rënie prej 135 materialesh, në vitin 2018, nderkohe që në përqindje, pasqyrohet në një rënie prej 2 %, si vijon:


<sup>1</sup> Gjithashtu ka qenë edhe 1 çështje penale e rregjistruar sipas nenit 36 të K.Penal Ushtarak, e cila është dërguar për gjykim, por nuk është përfunduar gjykimi.

### Volumi në hetim




Procedimet penale, në raport të dy viteve, tregojnë për një rritjeprej 190 procedimesh penale, ose shprehur në përqindje, një rritje me 4% të procedimeve penale në vitin 2018.

### Procedime penale




Materialet kallzuese, në raport të dy viteve, tregojnë për një rënie prej 325 materialesh ose shprehur në përqindje, një rënie prej 16% të kallzimeve penale në vitin 2018.

### Materialet kallzuese



Në këtë aspekt, vlerësohet se ndryshimet e ndodhura me ligjin nr. 35/2017 datë 30.03.2017 të Kodit të Procedurës Penale, në nenin 291 të tij, kur prokurorit i lihet maksimumi 15 ditë kohë të vendosë për fillimin apo mosfillimin e procedimit penal, ka sjellë rritjen e numrit të procedimeve penale.



Duhet theksuar se nga prokurorët janë dërguar edhe 488 kërkesa pushimi për parashkrim në gjykatë, për çështjet e pezulluara ndër vite dhe për të cilat është vendosur rifillimi për shkak parashkrimi. Pavarësisht se në të dhënat statistikore vjetore nuk pasqyrohen, kjo tregon për një ngarkesë pune të prokurorëve, pasur parasysh edhe ndryshimet e reja të K.Pr. Penale.

### 1.1.Raporti i çështjeve të reja me të mbarturat dhe prurjet e tjera:


Nga numri i tërësisë së materialeve penale, evidentohet se:

- 797 procedime penale kanë qenë të mbartura nga viti i kaluar;
- 2378 janë rregjistruar procedime penale të reja (përfshirë të rregjistruarat të reja dhe ato që kanë ardhur për kompetencë, konkretisht 6 të tilla)<sup>2</sup>;
- 17 janë rifilluar;
- Ndërkohë rezultojnë se janë mosfilluar 784 materiale (nga të cilat për 181 materiale të mosfilluara, nuk është gjendur kualifikimi i ndonjë veprë penale);
- Janë ende në verifikim 98 materiale kallzuese;
- Janë përcjellë për kompetencë 6 materiale kallzuese
- Janë bashkuar 6 materiale kallzuese me procedime penale apo materiale të tjera kallzuese.

Pra në përqindje rezultojnë se nga tërësia e materialeve, duke i ndarë në procedime penale dhe materiale kallzuese, rezultojnë se 58 % përbëjnë procedime penale të reja, 22 % materiale kallzuese (përfshihen mosfillimet, kallzimet që kanë mbetur në verifikim dhe ato të transferuara apo të bashkuara) dhe 20 % janë procedime penale të mbartura.

Në përqindje raporti i çështjeve, paraqitet në grafikun si vijon:


<sup>2</sup> Gjithashtu është rregjistruar edhe 1 çështje sipas nenit 36 të K.Penal Ushtarak, e cila është dërguar për gjykim por nuk ka përfunduar gjykimin




### 1.2.Puna e kryer në total

Kjo prokurori ka përfunduar hetimet për 2862<sup>3</sup> materiale, ndërkohë që i kanë mbetur në hetim 1126 procedime penale dhe 98 materiale kallëzuese në verifikim.

#### Viti 2018



#### Viti 2017



Pra konstatohet një rënie e punës, nga ana e kësaj prokurorie, e cila pasqyrohet në një rritje prej 10 % të çështjeve të papërfunduara.

Duhet theksuar se në këtë faktor ka ndikuar respektimi i afatit 10 ditor, sipas nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, i cili detyrimisht bën që të zgjaten hetimet kur i pandehuri kërkon të pyetet apo të merren prova të reja. Të pandehurit, nuk ushtrojnë pergjithesisht të drejtat e tyre, në rol aktiv gjatë hetimit, në mënyrë që prej tyre të kërkohen hetime të ndryshme për marrje provash apo edhe viktime, pavarësisht të drejtave të përcaktuara në nenin 58 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale. Këto të drejta, konstatohen se i ushtrojnë vetëm pasi njihen me aktin e

<sup>3</sup> Shih foot note 1 dhe 2

njoftimit të përfundimit të hetimeve. Kjo gjë shkakton detyrimisht zgjatjen e afatit të hetimit. Për këtë arsye kërkohet një ndërgjegjësim më i madh, qoftë i të pandehurit ashtu edhe viktimave të veprave penale.

Një fakt tjetër që vlen të vlerësohet është se në këtë prokurori, ka një mungesë tashmë prej 4 prokurorësh që hetojnë dhe përfaqësojnë veprat penale në gjykim si dhe një mungesë prej 3 oficerësh të policisë gjyqësore, që ka ardhur si për shkak të shkurtimit të organikës, ashtu edhe për shkak të largimit të tyre për arsye të ndryshme.


Gjithashtu, vlerësohet se një faktor tjetër i uljes së efektivitetit në punë, ka të bëjë me dispozitat e reja procedurale penale, pasi tashmë prokurorit i duhet të përballet me gjyqtarin e seancës paraprake përpara vendosjes përfundimisht të dërgimit të çështjes për gjykim apo pushim dhe në këtë pjesë, duhet të përlogaritur edhe koha e gjykatës për vendimmarrje, e cila mund të jetë edhe kthimi i akteve prokurorit për vazhdimin e hetimeve.


Pikërisht këta faktorë, megjithëse janë ndër faktorët që kanë sjellë rënien e efektivitetit në hetim, duhet të shërbejnë si një nxitës i mëtejshëm i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, për të treguar se mund të përballojnë punën pavarësisht ndryshimeve.

### **1.3.Raporti i përfundimit të çështjeve dhe atyre të ngelura në hetim:**

Rezulton të jenë përfunduar 796 materiale kallzuese (784 vendime mosfillimi, 6 materiale kallzuese përcjellë për kompetencë, 6 bashkuar me çështje të tjera), përfunduar 2066 proçedime penale (bashkë me transferimet për kompetencë dhe procedimin penal për veprën penale të parashikuar nga K.Penal Ushtarak). Kanë ngelur në hetim 1126 proçedime penale dhe 98 materiale kallzuese në verifikim.

Pra në përqindje rezulton se nga tërësia e materialeve të përfunduara, 51% janë proçedime penale, 19 % materiale kallzuese me vendim mosfillimi dhe kanë ngelur në hetim 28 % proçedime penale e për verifikim 2% materiale kallzuese.





## 2. Çështje të përfaqësuara në gjykatë

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka përfaqësuar në gjykim, për vitin 2018, 1098 çështje, nga të cilat 247 kanë qenë çështje të mbartura në gjykim nga viti 2017 kurse 851 çështje janë dërguar për gjykim në vitin 2018 (përfshirë të dhënat për K.Penal Ushtarak). Gjithsej në gjykim kanë qenë 1213 të pandehur, nga të cilët 245 të arrestuar.

Sa më lart, janë tregues vetëm për çështjet ku prokurori përfaqëson akuzën, duke mos përmendur çështjet në të cilat prokurori ka marrë pjesë në gjykim, me të dëmtuar akuzes apo raste të tjera si heqje zotësie për të vepruar, kërkesat për pushim të procedimeve penale të cilat janë filluar për parashkrim etj.




Referuar raportit të çështjeve të përfaqësuara në gjykim, dy viteve të fundit, pra 2018 dhe 2017, rezulton se:




Pra në përqindje konstatohet se në vitin 2018, kjo prokurori ka përfaqësuar në gjykim, 110 çështje më shumë se në përqindje 6 % më shume çështje se sa në vitin e kaluar.

**3. Treguesit Kryesor të punës së prokurorisë (vendime mosfillimi, procedime pushuar, pezulluar, transferuar, dërguar për gjykim dhe të pandehur/persona që lidhen me to;**


**Për vitin 2018**, është vendosur mosfillimi për 784 çështje penale, janë pushuar 512 çështje penale, pezulluar 670 çështje, transferuar 39 çështje (përfshijmë edhe kallzimet e transferuara) dhe dërguar për gjykim 851 çështje. Në përqindje ky raport shprehet në këtë mënyrë:




**Për vitin 2017**, është vendosur mosfillimi për 1137 çështje penale, janë pushuar 639 çështje penale, pezulluar 792 çështje, transferuar 32 çështje (përfshire edhe kallzimet e transferuara) dhe dërguar për gjykim 766 çështje. Në përqindje ky raport shprehet në këtë mënyrë:



## Raporti i çështjeve të përfunduara në vitet 2017 dhe 2018




Në lidhje me **proçedimet e përfunduara** për vitin 2018 kanë qenë 2066 proçedime penale, ndërkohë që për vitin vitin 2017 kanë qenë 2226 proçedime penale. Pra në vitin 2018, janë përfunduar 4% çështje më pak se viti i kaluar ose **160 proçedime penale më pak**.



### 3.1. Proçedime penale mbetur në hetim

Në vitin 2018 mbartëm për vitin në vijim 1126 proçedime penale, ndërkohë që në përfundim të vitit 2017 mbartëm 776. Kjo tregon se kemi mbartur 350 procedime penale më shumë. Ky është një tregues negativ për punën e kryer. **Kemi lënë për ndjekje për vitin 2018, një shifër prej 18% proçedime penale më shumë se viti i kaluar.**





Rezultojnë gjithsej 1126 proçedime penale në ndjekje, me 166 persona nën hetim, 45 të arrestuar.


- Veprat penale që kanë të bëjnë me *vjedhjen e pasurisë*, n. 134 – 142 të K.Penal, janë gjithsej **251 çështje penale**, me 14 persona nën hetim, 8 të arrestuar. Për vjedhje sipas nenit 134 të Kodit Penal, janë gjithsej 200 çështje penale.
- Veprat penale *kundër rendit dhe sigurisë publike*, n. 261 – 299 të K.Penal, janë **gjithsej 231 çështje**, me 69 persona nën hetim, 19 të arrestuar. Theksohet se 54 prej tyre janë të rregjistruara për veprën penale të “*Prodhimit dhe shitjes së narkotikëve*” parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal dhe 58 çështje janë për shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor ose drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt, parashikuar nga nenet 290 dhe 291 të Kodit Penal.
- Vepra penale që *cënojnë regjimin juridik të tokës*, n. 199 – 200 të K.Penal, janë gjithsej **100 çështje**, me 1 persona nën hetim. Theksohet se 96 prej tyre janë të rregjistruara për veprën penale të ndërtimit të paligjshëm.
- Veprat penale të *shkatërrimit të pronës*, n. 150 – 162 të K.Penal, janë gjithsej **74 çështje penale**, me 4 persona nën hetim, 1 i arrestuar. Konstatohet si problematikë që 32 çështje penale janë për veprën penale të shkatërrimit të pronës me zjarr.
- Veprat penale *kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërore ose në shërbim publik*, n. 248 – 260 të K.Penal, janë gjithsej **71 çështje penale**, me 5 persona nën hetim, 1 i arrestuar. Theksohet se 64 prej tyre janë të rregjistruara për veprën penale të shpërdorimit të detyrës, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal;
- Vepra penale të *falsifikimit të dokumentave*, n. 186 – 192/b të K.Penal, janë gjithsej **60 çështje penale**, me 11 persona nën hetim. Nga këto theksohet se 40 çështje penale janë të rregjistruara për veprën penale të falsifikimit të dokumentave, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.
- Vepra penale *kundër drejtësisë* n. 300 – 324 të K.Penal, janë gjithsej **55 çështje penale**, me 5 persona nën hetim, 2 të arrestuar. Theksohet se 14 çështje penale janë të rregjistruara për veprën penale të pengime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore, parashikuar nga neni 320 i K.Penal dhe 29 për veprën penale të futjes ose mbajtjes së sendeve të ndaluara në IEVP, parashikuar nga neni 324/a i Kodit Penal.
- Vepra penale me *dashje kundër shëndetit*, n. 86 – 90 i K.Penal, janë gjithsej **40 çështje**, me 9 persona nën hetim, 1 i arrestuar. Theksohet se 37 çështje janë për veprën penale të plagosjes së lehtë me dashje.
- Vepra penale *kundër fëmijëve, martesës dhe familjes*, n. 124 – 130/a të K.Penal, janë gjithsej **39 çështje**, me 13 persona nën hetim, 5 të arrestuar. 31 çështje penale janë për dhunën në familje.

- Vepra penale *që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës*, n. 93 – 99 të K.Penal, janë gjithsej **38 çështje**. Theksohet se 34 çështje janë për veprën penale të shkaktimit të vetvrasjes.
- Veprat penale të *mashtimit* janë gjithsej **28 çështje penale**, me 1 person nën hetim;
- Vepra penale *kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga shtetasit*, n. 235 – 247 të K.Penal, janë gjithsej **28 çështje penale**, me 12 persona nën hetim, 2 të arrestuar. Theksohet se 11 prej tyre janë të rregjistruara për veprën penale të mosbindjes ndaj urdhërit të punonjësit të policisë së rendit publik, parashikuar nga neni 242 i Kodit Penal.
- Vepra penale *kundër jetës të kryera me dashje*, n. 76 – 84/a të K.Penal, janë gjithsej **24 çështje penale**, me 9 persona nën hetim, 3 të arrestuar (në raportin në fillim do të gjeni disa të dhëna shtesë që i përkasin rifillimeve të dosjeve të vjetra të cilat nuk janë pasqyruar në statistikat e përgjithshme të kësaj prokurorie). Theksohet se 7 janë për veprën penale të vrasjes së mbetur në tentativë, 8 për vrasje me paramendim, 4 për veprën penale të vrasjes, 3 për veprën penale të vrasjes së në rrethana të tjera cilësuese (pra 22 çështje penale janë për veprën penale të vrasjes).
- Vepra penale *kundër moralit dhe dinjitetit*, n. 113 – 123 të K.Penal, janë gjithsej **21 çështje penale**, me 5 person nën hetim, 1 të arrestuar;
- Vepra penale *kundër mjedisit*, n. 201 – 207 të K.Penal, janë gjithsej **19 çështje penale**, me 1 person nën hetim;
- Veprat penale *në lidhje me taksat dhe tatimet* janë gjithsej **18 çështje penale**, me 1 person nën hetim;
- Vepra penale *në lidhje me lojërat e fatit*, n. 197 – 198 i K.Penal janë gjithsej **8 çështje penale**;
- Vepra penale në *fushën e doganave*, n. 171 – 179/ç të K.Penal, janë gjithsej **6 çështje penale**, me 1 person nën hetim;
- Veprat penale *në shoqëritë tregtare*, n. 163 – 170/b të K.Penal, janë gjithsej **5 çështje penale**.
- *Krime seksuale*, n. 100 – 108/a/2 i K.Penal, janë gjithsej **3 çështje penale**, me 2 persona nën hetim, 1 i arrestuar;
- Vepra penale *kundër sekretit dhe kufijve shtetërore*, n. 294 – 299 të K.Penal, janë gjithsej **4 çështje penale**, me 2 persona nën hetim;
- Vepra penale në lidhje me *falsifikimin e monedhave* është gjithsej **1 çështje penale**;


- Vepra penale që *prekin zgjedhjet e lira dhe sistemin demokratik të zgjedhjeve*, është gjithsej **1 çështje penale**;
- *Krime kundër jetës shkaktuar me pakujdesi*, n. 85 i K.Penal, është gjithsej **1 çështje penale**;

Krahasimi në përqindje i veprave penale të mbetura në hetim ndërmjet dy viteve:

### Viti 2017



### Viti 2018




Pra në vitin 2018, nga procedimet që kanë ngelur në hetim, pjesën më të madhe e zenë ato që janë rregjistruar për veprën penale të vjedhjes, njësoj si në vitin 2017.

### 3.2 Vendimet e mosfillimit


Për vitin 2018 janë mosfilluar gjithsej 784 çështje, nga të cilat 181 kanë qenë të pakualifikuara në referim për ndonjë vepër penale. Theksojmë se gjithashtu 6 materiale kallzuese janë transferuar në prokuroritë e tjera për kompetencë dhe 6 materiale kallzuese janë bashkuar me çështje të tjera në verifikim apo heitim nga kjo prokurori.

Ndërkohë në vitin 2017, janë mosfilluar 1137 çështje, nga të cilat 314 kanë qenë të pakualifikuara në referim për ndonjë vepër penale.


Në mënyrë grafike paraqiten si vijon:



Veprat penale dominuese për të cilat është vendosur mosfillimi për vitin 2018 paraqiten si më poshtë:




Veprat penale dominuese për të cilat është vendosur mosfillimi në vitin 2017, paraqiten si më poshtë:



### 3.3 Pushimet e çështjeve

Në lidhje me **çështjet e pushuara** konstatohet se për vitin 2018 janë pushuar 512 çështje, me 130 persona nën hetim dhe 4 të arrestuar. **Pra ka një rënie të numrit të pushimeve të çështjeve me 127 proçedime penale ose me 12 % më pak në krahasim me vitin e kaluar.**



Në vitin 2018, janë pushuar 512 çështje, me 130 persona në hetim, 7 persona të arrestuar. Çështjet penale në lidhje me personat e arrestuar, për të cilat është vendosur pushimi, kanë qenë për veprat penale si më poshtë:


- 1 i pandehur, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal<sup>4</sup>.
- 1 i pandehur, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 134/2 i K. Penal. Prokurorja ka kërkuar vetë pushimin, për këtë të pandehur, pasi nuk provohej të kishte kryer veprën penale, ndërkohë që ka kërkuar dërgimin në gjyq për të pandehurit e tjerë. Kur është bërë kërkesa për pushim, të pandehurit, i ishte zëvendësuar masa e sigurimit.
- 1 i pandehur, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal<sup>5</sup>.
- 1 i pandehur, i akuzuar për kryerjen e veprës penale, të parashikuar nga neni 151 i K.Penal.
- 1 i pandehur i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 136 e 22 i K.Penal.
- 1 i pandehur, i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 130/a/4 i K.Penal.
- 1 i pandehur, i akuzuar për nenin 135 të K.Penal<sup>6</sup>.

Në mënyrë grafike, pushimet e çështjeve, personave nën hetim dhe të arrestuarëve, për krahasimin me vitin e kaluar, paraqiten si vijon:

<sup>4</sup>Nuk është pasqyruar në tabelat statistikore nga zyra e regjistrimit


<sup>5</sup> Gjendet tek të dhënat e çështjeve të pushuara në gjykim

<sup>6</sup> Nuk është pasqyruar në të dhënat statistikore nga zyra e regjistrimit




Në vijim paraqesim në mënyrë grafike të dhënat në lidhje me veprat penale mbizotëruese për të cilat janë marrë më shumë vendime pushimi, në krahasim të të dy viteve:

#### Viti 2017




#### Viti 2018



Çështjet penale në vitin 2018, janë pushuar në 504 raste për shkaqe të tjera, në 5 raste për mungesë prove dhe në 3 rast për mungesë fakti.

Në mënyrë grafike paraqiten si vijon:



### 3.4 Kërkesat për pushim

Në vitin 2018, rezulton se gjykatës i janë dërguar 414 kërkesa për pushim çështje ose akuze, me 107 persona nën hetim të ndarë sipas këtyre kategorive të veprave penale:

- 168 kërkesa për pushim *për vepra penale kundër pasurisë* (nga të cilat 41 për veprat penale të vjedhjes, 39 kërkesa për shkatërrim pronë, 59 kërkesa për pushim kundër rregjimit të tokës), me 12 persona nën hetim;
- 153 kërkesa për pushim *për vepra penale kundër autoritetit të shtetit* (38 prej tyre janë për veprat penale të shpërdorimit të detyrës), me 73 persona nën hetim;
- 79 kërkesa për pushim *për vepra penale kundër personit dhe krime kundër jetës* (47 prej të cilave kanë qenë për shkak të vetvrasje), me 21 persona nën hetim;
- 11 kërkesa për pushim *për vepra penale kundër mjedisit*;
- 3 *për vepra penale kundër drejtësisë*, me 12 person nën hetim.

*Vendimet e gjykatës në lidhje me kërkesat për pushim konstatohet se janë:*

- 176 çështje është pranuar kërkesa e prokurorit për pushim.
- 10 çështje nuk është pranuar kërkesa e prokurorit për pushim duke u vendosur kthimi i akteve dhe vazhdimi i hetimeve;


Gjithashtu, siç theksuam edhe më sipër, nga prokurorët janë dërguar në gjykatë edhe 488 kërkesa pushimi për parashkrim, për çështjet e pezulluara ndër vite dhe për të cilat është vendosur rifillimi për shkak parashkrimi. Pavarësisht se në të dhënat statistikore vjetore nuk pasqyrohen, kjo tregon për një ngarkesë pune të prokurorëve, pasur parasysht edhe ndryshimet e reja të K.Pr. Penale.

### 3.5. Vendimet e pezullimit


Në lidhje me **çështjet e pezulluara** konstatohet se për vitin 2017 janë pezulluar 792 proçedime penale, ndërkohë që vitin 2018 janë pezulluar 670 proçedime penale. Pra numri rezulton në rënie për vitin 2018, me një numër procedimesh prej 122 më pak të pezulluara se vitin e kaluar.

Të gjitha vendimet e pezullimit kanë pasur si shkak moszbulimin e autorëve.

Për vitin 2018, proçedimet penale të pezulluara, paraqiten grafikisht si më poshtë.



Veprat penale dominuese në vendimet e pezullimit në vitin 2017 janë si më poshtë:





### 3.6. Transferimet

Për vitin 2017 rezulton të jenë transferuar 29 procedime penale, me 11 persona nën hetim, 4 të arrestuar.


Për vitin 2018 rezulton të jenë transferuar 33 procedime penale, me 9 persona nën hetim, 3 të arrestuar.

### 3.7. Çështje të dërguara në gjykim referuar numrit total të procedimeve të hetuara


Pasur parasysh numrin total të **procedimeve penale të hetuara** në prokurori **përgjatë vitit 2018**, që është 3192 çështje, rezulton se janë dërguar për gjykim 851 çështje, me 936 të pandehur nga të cilët 191 kanë qenë të arrestuar.

Pasur parasysh numrin total të **procedimeve penale të hetuara** në prokurori **përgjatë vitit 2017**, që është 3002 çështje, rezulton se janë dërguar për gjykim 766 çështje, me 871 të pandehur nga të cilët 287 kanë qenë të arrestuar.

Duke iu referuar **procedimeve penale që janë hetuar**, në vitin 2017 dhe 2018 konstatohet ky raport i dërgimit të çështjeve për gjykim:




Përqindja e çështjeve të dërguara për gjykim në krahasim të viteve 2018 dhe 2017:




**Pra, kemi një rritje prej 6 % të procedimeve të dërguara në gjykim në vitin 2018 krahasuar me vitin 2017, ndërkohë që në raport me numrin total të çështjeve, konstatohet se në vitin 2017 janë dërguar për gjykim, 1% më shumë se vitin e kaluar.**

**Numri i të pandehurve të dërguar për gjykim në vitin 2017 ka qenë 871, nga të cilët 287 të arrestuar, ndërkohë që në vitin 2018 vihet re se ka qenë një numër më i lartë, pasi ky numër është 936, nga të cilët 191 të arrestuar. Koncretisht janë dërguar për gjykim 65 më shumë të pandehur, për gjykim.**

Në vitin 2018, është konstatuar se numri total i të pandehurve dhe personave nën hetim, të regjistruar, ka qenë 1241 nga të cilët 936 janë dërguar për gjykim, 191 kanë qenë të arrestuar.




Ndërkohë në vitin 2017, rezulton ky raport, ndërmjet të pandehurve të dërguar për gjykim me disponimet e tjera për ta:




Rezulton se në krahasim me vitin e kaluar janë dërguar për gjykim 5 % më shumë të pandehur.

Nga të pandehurit e dërguar për gjykim, në numër total 936, rezulton se 191 prej tyre kanë qenë të arrestuar. Në krahasim me vitin 2017, konstatohet:



### 3.8. Disponimi në total për procedimet penale

Në mënyrë grafike paraqesim procedimet penale në total dhe disponimi për to, në krahasim me dy vitet.




### 3.9. Disponimi në total për personat nën hetim dhe të pandehurit


Persona nën hetim për vitin 2018 kanë qenë 305 kurse të pandehur kanë qenë 936. Në total numri i personave nën hetim dhe të pandehurve për vitin 2018 është 1241.

Persona nën hetim për vitin 2017 kanë qenë 369 kurse të pandehur kanë qenë 871. Në total numri i personave nën hetim dhe të pandehurve për vitin 2017 është 1 240.

Më poshtë paraqesim të dhënat për personat nën hetim dhe të pandehurit sipas mënyrës së përfundimit të çështjeve dhe vazhdimet të ndjekjes penale.




Duke pasur parasysh numrin total të personave nën hetim dhe të të pandehurve të rregjistruar për vitin 2017 dhe 2018, paraqesim në mënyrë grafike personat për të cilët është përfunduar hetimi dhe ata për të cilët vazhdojnë hetimet.



Pra rezulton se për vitin 2018, janë përfunduar hetimet për 1% më shumë për personat nën hetim dhe të pandehurit.

#### 4. Të dhënat në lidhje me njoftimet për veprat penale

Në vitin 2018 ka pasur 2974 kallzime dhe referime. Në krahasim me vitin 2017, **vërehet një rritje e referimeve, ngjarjeve, kallzimeve në një shifër prej 698 materialesh**. Pra në përqindje konstatohet një rritje prej 14% në vitin 2018.



Kallzime nga policia e shtetit ka pasur 1243 në vitin 2017 kurse në vitin 2018 ka pasur 1737, shifër e cila është 494 referime më shumë.

Në vitin 2017 ka pasur 765 ngjarje kurse në vitin 2018 ka pasur 972 ngjarje, ose **207 ngjarje më shumë**;

Në vitin 2017 ka pasur 61 kallzime penale nga shtetasit, kurse në vitin 2018 ka pasur 119 kallzime nga shtetasit ose **58 kallzime më shumë**.

Në vitin 2017 ka pasur 207 kallzime nga nëpunësit publikë ndërkohë që në vitin 2018 ka pasur 146 kallzime nga nëpunësit publikë, ose **61 kallzime më pak**.

Në vitin 2017 ka pasur 7 çështje të filluara kryesisht nga prokurori, kurse nga prokurorët e kësaj prokurorie rezultojnë në vitin 2018, të jenë rregjistruar kryesisht 5 procedime penale. Konkretisht veprat penale për të cilat janë kryer rregjistrimet e procedimeve penale janë:


- 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 259 i K.Penal;
- 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i K.Penal,
- 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 306 i K.Penal,

- 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 190 i K.Penal,
- 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 245/1 të K.Pr.Penale.


**Referimet apo kallzimet per veprat penale  
jane kryer ne keto perqindje nga subjekte te ndryshme**

**Viti 2017**

**Viti 2018**



**Në një krahasim të viteve 2017 dhe 2018** vihet re si më poshtë në grafik, luhatja e referimeve:




**5. Të dhëna në lidhje me masat e sigurimit personal dhe pasuror**

**5.1. Masat shtrënguese dhe ndaluese**

Gjatë vitit 2018, janë paraqitur në gjykatë, gjithsej 511 kërkesa për caktim të masave të sigurimit personal dhe 3 kërkesa për masa ndaluese. Gjykatat për vitin 2018 kanë vendosur të japin 509 masa shtrënguese dhe 3 masa ndaluese. Në krahasim me vitin 2017, kemi një rritje prej 10% të kërkesave të prokurorit për caktimin e masave shtrënguese.





## Viti 2018



Nga prokurori është urdhëruar në 1 **rast lirimi i menjehershëm** i personit (konkretisht në 1 rast për nenin 290/1 të Kodit Penal), ndërkohë që është kërkuar në gjykatë në **501 raste vlerësimi si i ligjshëm** i arrestit në flagrancë apo i ndalimit dhe **gjykata i ka vlerësuar si të ligjshme në 501 raste**.

Raporti i arrestimeve dhe ndalimeve në dy vitet 2017 dhe 2018:




Nga prokurori janë paraqitur gjithsej **511 kërkesa për caktim mase shtrënguese** ndërkohë që **gjykata ka vendosur për to në 509 raste**.


- Prokurori ka kërkuar caktimin e **masës së sigurimit me arrest në 242 raste dhe nga gjykata është caktuar kjo masë në 219 raste:**
  - Në 220 raste është kërkuar caktimi i **masës së sigurimit “arrest në burg”**, n. 238 i K.Pr.Penale dhe gjykata e ka vendosur këtë masë në 196 raste.
  - Në 16 raste nga prokurori është kërkuar caktimi i masës së sigurimit **“arrest në burg me afat”** n. 238 e 245/ç i K.Pr.Penale dhe nga gjykata është vendosur në 13 raste.
  - Në 3 raste nga prokurori është kërkuar caktimi i masës së sigurimit **“arrest në shtëpi”** n. 237 i K.Pr.Penale dhe nga gjykata është vendosur në 7 raste.
  - Në 3 raste është kërkuar caktimi i **masës së sigurimit “arrest në burg” në mungesë**, n. 238 i K.Pr.Penale dhe gjykata e ka vendosur këtë masë në 3 raste.

- Nga prokurori është kërkuar në **269 raste caktimi i masës së sigurimit detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore n. 234 i K.Pr.Penale** ndërkohë që gjykata e ka caktuar këtë masë sigurimi në **291 raste**.
- Nga prokurori në **3 raste është kërkuar masë ndaluuese** dhe nga gjykata është vendosur në **3 rast kjo masë sigurimi**.

Në vitin 2018, në përqindje pasqyrohen masat në këtë mënyrë:



Në vitin 2017 ka qenë ky raport:




## Raporti i kërkesave me vendimet gjyqesore në vitin 2018:



Gjithashtu nga prokurori është kërkuar dhe nga gjykata janë vendosur edhe 3 masa sigurimi ndaluese.


## Krahasimi i kërkesave te prokurorit ndërmjet viteve 2017 dhe 2018:



Krahasimi në përqindje i kërkesave të prokurorit për masat e sigurimit, në vitet 2017 dhe 2018 paraqiten si më poshtë:




**Kërkesat e prokurorit:**



Raporti në përqindje i kërkesave të prokurorit për vitin 2017 dhe 2018 në lidhje me masat e sigurimit dhe vendimet e gjykatës:


**Kerkesat e prokurorit**

**Vendimet e gjykatës**



**Kerkesat e prokurorit**

**Vendimet e gjykatës**




## 5.2. Masat e sigurimit pasuror

Përgjatë vitit 2018, është kërkuar vendosja e masës së sigurimit pasuror e sekuestros preventive në kuadër të hetimeve të procedimit penal nr. 318 të vitit 2018 për pasuritë e mëposhtme:


- 7) Pasuria e llojit apartament, pranë ZVRPP Elbasan;
- 8) Pasuria sipërfaqe 5200 m<sup>2</sup>, pranë ZVRPP Elbasan;
- 9) Pasuria e llojit njësi, me sipërfaqe 144 m<sup>2</sup>, pranë ZVRPP Elbasan;
- 10) Pasuria lloji i pasurisë Njësi, sipërfaqja totale 48,2 m<sup>2</sup>, pranë ZVRPP Elbasan;
- 11) Pasuria pranë ZVRPP Elbasan.
- 12) 100% të kuotave të zotëruara nga në 1 shoqëri tregtare

## 6. Treguesit e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore penale të formës së prerë


Gjate vitit 2018, nga Prokurorët e Prokurorisë Elbasan janë nxjerrë gjithsej 2251 urdhëra për ekzekutimin e vendimeve penale. Nga 2251 urdhërat e ekzekutimit të nxjerra, janë ekzekutuar 1678 urdhëra ekzekutimi, duke mbetur pa u ekzekutuar 573 urdhëra ekzekutimi.



Në grafik urdhërat e ekzekutimit të lëshuar nga kjo prokurori, për vitin 2018, sipas zërave të veçantë, paraqiten në këtë mënyrë:




Referuar llojit të dënimit, në mënyrë grafike, në përqindje paraqiten urdhërat e ekzekutimit për vitin 2018:



*Në shifra konkrete, urdhërat e ekzekutimit të lëshuar nga kjo prokurori, janë të evidentuar si më poshtë:*

- 771 urdhëra ekzekutimi për denimet me kusht;
- 58 urdhëra për dënimet me punë publike,
- 180 urdhëra ekzekutimi për dënim me burgim;
- 119 urdhëra ekzekutimi për dënim me gjobë;
- 11 urdhëra për dënim plotësues,
- 815 urdhëra ekzekutimi për shpenzimet proceduriale,
- 189 urdhëra ekzekutimi për provat materiale,
- 3 urdhëra për ndryshim lloj sigurie,
- 14 urdhëra ekzekutimi për shfuqizim urdher ekzekutimi,
- 8 urdhëra ekzekutimi për masat mjekësore të mjekimit të detyruar,
- 12 urdhëra për njohje paraburgimi për të dënuarit që janë ekstraduar,
- 34 urdhëra ekzekutimi për bashkim dënimi,
- 11 urdhëra ekzekutimi për njohje vendimi penal të huaj,
- 10 urdhëra revokim dënimi me kusht
- disa urdhëra të tjera për vendime të dhëna nga gjykata.

Në vitin 2018 kanë mbetur pa u ekzekutuar 573 urdhëra ekzekutimi të cilat sipas zërave ndahen në përqindje si më poshtë:



***Kane mbetur pa u ekzekutuar 573 urdhëra ekzekutimi prej të cilave:***

- 21 urdhëra ekzekutimi me burgim,
- 84 urdhëra ekzekutimi me gjobë,
- 468 urdhëra ekzekutimi për shpenzimet proceduriale të vitit 2018
- disa urdhëra ekzekutimi që janë nxjerrë gjatë këtij nëntë mujori

Kane mbetur pa ekzekutuar:

- 123 urdhëra ekzekutimi të dënimeve me gjobë të vitit 2016 dhe 2017 për të cilat nga zyra e shërbimit përmbartimor vazhdojnë procedurat e ekzekutimit, meqenëse nuk janë konsumuar afatet e vjeljes së gjobës të caktuara nga gjykata .

Kane mbetur pa ekzekutuar:

- 409 urdhëra ekzekutimi për shpenzimet proceduriale të vitit 2017,
- 519 urdhëra ekzekutimi për shpenzimet proceduriale të vitit 2016,
- 546 urdhëra ekzekutimi për shpenzimet proceduriale të vitit 2015,
- 661 urdhëra ekzekutimi për shpenzimet proceduriale të vitit 2014,
- 282 urdhëra ekzekutimi për shpenzimet proceduriale të vitit 2013,
- 401 urdhëra ekzekutimi për shpenzimet proceduriale të vitit 2012,
- 283 urdhëra ekzekutimi për shpenzimet proceduriale të vitit 2011,
- 163 urdhëra ekzekutimi për shpenzimet proceduriale të vitit 2010
- 64 urdhëra ekzekutimi të vitit 2009,

Mbetja pa u ekzekutuar e këtyre urdhërave, ka si shkak edhe faktin se shërbimi përmbartimor funksionon shumë pak për shkak të reformës që është ndërmarrë dhe numrit të pakët të punonjësve që ka.

Që nga viti 2017 dhe gjatë këtij viti për urdhërat e paekzekutuara, nga Zyra e Shërbimit Përmbartimor Elbasan, është vendosur pezullimi i ekzekutimit të urdhërit të ekzekutimit për shpenzimet gjyqësore për arsye se debitori nuk ka patur mjete financiare dhe pasuri të sekuestrueshme për 490 urdhërat e mbetura paekzekutuar, të ndara keto sipas viteve:

- për vitin 2017 për 21 të dënuar, për vitin 2016 për 31 të dënuar, për vitin 2015 për 53 të dënuar, për vitin 2014 për 41 të dënuar, për vitin 2013 për 46 të dënuar, për vitin 2012 për 128 të dënuar, për vitin 2011 për 86 të dënuar, për vitin 2010 për 57 të dënuar, për vitin 2009 për 27 të dënuar .

Kanë mbetur pa ekzekutuar nga vitet e tjera, 103 urdhëra ekzekutimi për dënimet penale me burgim, nga te cilat 4 urdhëra ekzekutimi për dënimet me burgim të përjetshëm.

Prokurorët kanë marrë pjesë ne gjykimet administrative penale të zhvilluara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan me objekt: “*Lirim para kohe me kusht*“, sipas nenit 64 të Kodit Penal, për 160 të dënuar dhe në perfundim të gjykimet:

- është kërkuar nga prokurori dhe vendosur nga Gjykata, rrëzimi i kërkesës për 18 të dënuar, pasi nuk kanë paraqitur asnjë arsye te veçantë dhe asnjë dokument tjetër për lirim me kusht, sikurse parashikohet nga neni 64 i Kodit Penal;
- është pushuar gjykimi për 11 të dënuar, pasi kanë hequr dorë nga kërkesa për lirim e tyre me kusht;
- janë pranuar 46 kërkesa për lirim me kusht nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, për 40 prej te cileve është kërkuar dhe nga Prokuroria ndërsa për 5 të dënuar është kërkuar rrëzimi i kërkesës, ndërsa nga Gjykata është vendosur pranimit i kërkesës për lirim me kusht dhe për keto raste është bërë Ankim ne Gjykatën e Apelit Durrës. Nga keto ankime janë shqyrtuar vetëm dy, dhe Gjykata e Apelit Durrës ka lënë në fuqi vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan.
- Është vendosur mospranimit i kërkesës sipas nenit 471 të K. Pr. Penale, për 79 të dënuar, nga të cilët 15 prej tyre nuk kishin plotësuar  $\frac{3}{4}$  e dënimit, 2 të dënuar kanë qenë përsëritës, për 62 të dënuar është vendosur mospranimit duke patur parasysh kërkesat e të dënuarve kanë qene përsëritur më parë, apo haptazi ne kundërshtim me kërkesat e ketij neni;
- është rrëzuar kërkesa për 18 të dënuar .

Gjatë këtij viti nga prokurorët është marrë pjesë në gjykimin e kërkesave të dënuarve me objekt ***ndryshimi i llojit të sigurisë*** për 33 të dënuar të cilët vazhdojnë të vuajnë dënimin në Seksionin e Sigurisë së Lartë të I.E.V.P.Peqin, për të cilët:

- nga Prokuroria është kërkuar dhe nga gjykata është vendosur rrëzimi i kërkesës për 16 të dënuar, prej të cileve 2 me akt ekspertimi te mjekësise ligjore Tiranë,
- pushimi i çështjes për 2 të dënuar për arsye se është hequr dore nga kërkesa,
- është kërkuar dhe është vendosur nga Gjykata mospranimit i kërkesës për 14 të dënuar

Nga ana e 32 të dënuarve është kërkuar ***gjykimi alternativ*** bazuar në nenin 59/a te Kodit Penal dhe:

- për 5 prej tyre është kërkuar rrëzimi i kërkesës nga Prokuroria dhe po keshtu eshte vendosur dhe nga Gjykata, për 3 raste është kërkuar nga Prokuroria dhe është vendosur pranimit nga gjykata, ne 3 raste është kërkuar nga Prokuroria dhe nga gjykata është

vendosur pushimi i gjykimit, për 20 kërkesa është vendosur mospranimi i kërkesës, për 1 rast është shpallur moskompetenca e gjykimit, për 1 kërkesë është vendosur moskompetenca për shkak të transferimit të dënuarit në një institucion tjetër vuajte dënimi..

Gjatë këtij viti nga ana e 24 të dënuarëve është kërkuar ***njohja e dënimit të kryer jashtë shtetit***, gjatë kohës së ekstradimit të tyre. Nga prokuroria është kërkuar:

- pranimi i kërkesës për 11 raste dhe nga gjykata është vendosur pranimi i kërkesës,
- për 4 të dënuar është kërkuar pushimi i gjykimit të kërkesës dhe nga gjykata është vendosur pushimi i gjykimit,
- për 3 kërkesa është kërkuar dhe është vendosur rrëzimi i kërkesës
- për 6 raste është kërkuar dhe është vendosur mospranimi i kërkesës sipas nenit 471 të K. Pr. Penale

Gjatë këtij viti nga 41 të dënuar është bërë ***kërkesë për bashkimin e dënimeve*** dhe:

- nga ana jonë është kërkuar pranimi i kërkesës për 31 kërkesa, dhe nga gjykata është vendosur mospranimi për 8 kërkesa
- për 1 kërkesë është vendosur moskompetenca.
- Është pushuar kërkesa për 1 të dënuar për arsye të heqjes dorë nga i dënuari.

Gjatë këtij viti është kërkuar ***shtyrja e ekzekutimit të dënimit me burgim*** nga 4 të dënuar dhe nga Prokuroria është kërkuar dhe nga Gjykata është vendosur rrëzimi i kërkesës për 3 të dënuar, mospranimi i kërkesës për 1 të dënuar .

Gjatë këtij viti është kërkuar ***parashkrimi i ekzekutimit të dënimit penal me burgim*** sipas nenit 68 të K. Penal dhe sipas nenit 480 të K. Pr. Penale, nga 8 të dënuar dhe nga Prokuroria është kërkuar dhe nga Gjykata është vendosur pranimi i kërkesës për 2 të dënuar, rrëzimi i kërkesës për 2 të dënuar, dhe mospranimi i kërkesës për 3 të dënuar, për 1 rast është vendosur pushimi i kërkesës.

Gjatë këtij viti nga të dënuarit që vuajne dënimin në I.E.V.P Peqin dhe Kosovë ka patur kërkesa dhe ankesa të cilat pasi janë shqyrtuar nga ana jonë, të dënuarve u është kthyer pergjigje ligjore.


Gjithashtu korrespondencë të vazhdueshme ka pasur edhe me Zyrtarë Vendore të Shërbimit të Provës dhe me IEVP-të.

## 7. Kriminaliteti sipas shtrirjes territorial të njësive administrative


Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e shtrin kompetencen e vet ne nje hapësirë gjeografike dhe demografike te madhe. Njohja me këto të dhëna, duke e ndërthurrur me faktorë të tjerë, çon në kuptimin e rezultateve të punës sonë dhe të faktit përse disa vepra penale vihen re të kenë epërsi mbi disa të tjera.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, e shtrin funksionin e vet në qarkun e Elbasanit.

Harta e qarkut Elbasan



Aktualisht, bazuar ne ligjin nr. 115 të vitit 2014 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Qarku Elbasan, ka si qendër të tij, qytetin e Elbasanit<sup>7</sup>.



<sup>7</sup>Fillimisht rregullimet për qarkun janë bërë në bazë të ligjit nr.8653 datë 31.07.2000 “Për ndarjen administrative territoriale të njësive të qeverisjes vendore në R.Shqipërisë”, i shfuqizuar.




## Ky qark përmbledh 7 bashki dhe 50 njësi administrative:

Numri i popullsisë në total, është 442637 banorë<sup>8</sup>.

Sipas Bashkive dhe njërive administrative që ato përmbledhin numri i popullsisë ndahet në këtë mënyrë (renditen sipas numrit më të madh):

1. Bashkia Elbasan – numri i banorëve 209 700;
2. Bashkia Cërrik – numri i banorëve 47 432;
3. Bashkia Librazhd – numri i banorëve 44 247;
4. Bashkia Peqin – numri i banorëve 38 939;
5. Bashkia Gramsh – numri i banorëve 36 062;
6. Bashkia Prrenjas – numri i banorëve 33 337;
7. Bashkia Belsh – numri i banorëve 32 880;

Në mënyrë grafike, përqëndrimi i popullsisë paraqitet në këtë mënyrë:




Pra, konstatohet se Bashkia Elbasan ka numrin më të madh të popullsisë, me 47 % të numrit total.


<sup>8</sup>Rregjistri i gjendjes civile 2017, ofruar nga Prefektura Elbasan

Më poshtë pasqyrohet në përqindje referimet e kryera dhe ngjarjet e ndodhura, pasur si burim, Drejtorinë e Policisë Vendore dhe Komisariatet përkatëse.

**Viti 2017:**




**Viti 2018:**




## 8. Kriminaliteti sipas peshës/përhapjes së veprave penale dhe tendencave të tyre

Sipas veprave penale të ndodhura, referimet e policisë gjyqësore, sipas shtrirjes territoriale konstatohet se janë referuar në këtë raport nga forcat policore:




### Viti 2017:





### Viti 2018:




Nga sa më sipër, mund të analizohet fakti se veprat penale më të përhapura janë ato kundër pasurisë, parashikuar nga nenet 134 – 200 të K.Penal. Si më poshtë pasqyrojmë kriminalitetin në përqindje sipas veprave penale dhe shtrirjes territoriale.





Procedime të regjistruara sipas seksioneve të Kodit Penal për vitet 2017–2018, vijojnë më poshtë:



Raporti i grup veprave me numrin e procedimeve të rregjistruara në prokurori, sipas strukturës së Kodit Penal, të shprehura në përqindje, **në krahasim të dy viteve është si vijon:**

Në vitin 2018, krime kundër jetës, me dashje janë rregjistruar 32 materiale, ose 28 % më shumë se në vitin 2017, kur ishin rregjistruar 18 materiale.

Në vitin 2018 kemi të rregjistruar 1 vepër penale kundër jetës të shkaktuar nga pakujdesia, ndërkohë që në vitin 2017 nuk kishim asnjë të tillë.

Në vitin 2018, Vepra penale me dashje kundër shëndetit janë rregjistruar 114 procedime penale të cilat qëndrojnë thuajse në të njëjtin nivel me vitin 2017, kur ishin rregjistruar 115 çështje të tilla.

Në vitin 2018 nuk janë rregjistruar vepra penale me pakujdesi kundër shëndetit ndërkohë që në vitin 2017 është rregjistruar 1 procedim penal.

Në vitin 2018, Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës janë rregjistruar 73 procedime penale. Në vitin 2017, Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës janë rregjistruar 32 procedime penale. Pra në përqindje, rezulton se për vitin 2018 janë rregjistruar 40 % më shumë.

Në vitin 2018 dhe 2017, procedime penale për Krime seksuale, janë rregjistruar për secilin vit nga 10 procedime penale të tilla.

Në vitin 2018, Vepra penale kundër lirisë së personit, janë rregjistruar 2 të tilla. Në vitin 2017, Vepra penale kundër lirisë së personit ishin rregjistruar 3.

Në vitin 2018, Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit janë rregjistruar 22. Në vitin 2017, Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit janë rregjistruar 15. Pra në vitin 2018 janë rregjistruar 10 % më shumë.

Në vitin 2018, Vepra penale kundër fëmijëve, martesës, familjes janë rregjistruar 102. Në vitin 2017, Vepra penale kundër fëmijëve, martesës, familjes ishin rregjistruar 108. Pra në vitin 2018 kemi një rënie me 2 % të këtyre veprave penale.

Në vitin 2018 dhe 2017 nuk ka pasur të rregjistruara procedime penale për Vepra penale kundër lirisë së besimit;

Në vitin 2018, vepra penale në lidhje me Vjedhjen e pasurisë kanë qenë 734. Në vitin 2017 numri i çështjeve të rregjistruar për Vjedhja e pasurisë ka qenë 708. Pra në vitin 2018, ka pësuar një rritje me 2 %.

Në vitin 2018, veprat penale në lidhje me Mashtrimet janë rregjistruar 30. Në vitin 2017, rregjistrimi i çështjeve për këto vepra penale, Mashtrimet, kanë qenë të rregjistruara 23. Pra në vitin 2018 kemi një rritje me 14 % të këtyre veprave penale.

Në vitin 2018, vepra penale që lidhen me Shkatërrimin e pronës janë rregjistruar 131. Në vitin 2017, vepra penale në lidhje me Shkatërrimin e pronës janë rregjistruar 153. Pra në 2018, kemi një rënie me 8 % të këtyre veprave penale.

Në vitin 2018 janë rregjistruar 13 vepra penale të kryera në shoqëritë tregtare, ndërkohë që në vitin 2017, ka qenë vetëm 1 vepër penale. Pra në përqindje reflektohet me një rritje prej 86 % më tepër.

Në vitin 2018 dhe 2017 nuk ka pasur të rregjistruara materiale për Vepra penale në lidhje me ushtrimin e veprimtarisë bankare dhe financiare;

Në vitin 2018, Krime në fushën e doganave kanë qenë të rregjistruara 9. Në vitin 2017, Krime në fushën e doganave, janë rregjistruar 8. Pra kemi diferencë me vetëm një material.

Në vitin 2018, Vepra penale në fushën e tatim taksave ka pasur të rregjistruara 17. Në vitin 2017, Vepra penale në fushën e tatim taksave janë rregjistruar 11. Pra në përqindje janë rregjistruar këtë vit 22 % më shumë.

Në vitin 2018, vepra penale në lidhje me Falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë kanë qenë 5. Në vitin 2017, vepra penale në lidhje me Falsifikimin e monedhave dhe letrave me vlerë kanë qenë 8. Pra rezulton se në vitin 2017 janë rregjistruar 24 % më shumë.

Në vitin 2018, vepra penale në lidhje me Falsifikimi i dokumentave janë rregjistruar 56. Në vitin 2017, vepra penale në lidhje me Falsifikimi i dokumentave janë rregjistruar 72. Pra janë rregjistruar 12% më shumë në vitin 2017.

Si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2017, nuk ka pasur të rregjistruara Vepra penale në fushën e falimentit;

Në vitin 2018, vepra penale në lidhje me Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit, janë rregjistruar 16. Në vitin 2017, vepra penale në lidhje me Zhvillimi i palejuar i lojërave të fatit janë rregjistruar 11. Pra rezulton të jenë rregjistruar në vitin 2018, 18% më shumë vepra penale.

Në vitin 2018, Vepra penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës janë rregjistruar 167. Në vitin 2017, Vepra penale që çënojnë rregjimin juridik të tokës janë rregjistruar 233. Pra në vitin 2018, janë rregjistruar 16 % më pak nga këto vepra penale se në vitin e kaluar.

Në vitin 2018 Vepra penale kundër mjedisit ishin rregjistruar 24. Në vitin 2017, janë rregjistruar 40. Pra konstatohet që në vitin 2018 ka një rënie me 26% të këtyre veprave penale.

Si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2017, vepra penale të parashikuara në Kreun V – VI – VII, nuk rezulton të jetë rregjistruar ndonjë çështje.



Në vitin 2018, Vepra penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga shtetasit janë rregjistruar 63. Në vitin 2017, janë rregjistruar 60. Pra kemi një luhajtje të vogël, me vetëm 3 procedime penal më shumë në vitin 2018.

Në vitin 2018, Vepra penale të kryera ndaj veprimtarisë shtetërore nga punonjësit janë rregjistruar 64. Në vitin 2017, janë rregjistruar 56. Pra konstatohet një rritje prej 6 % veprash penale më shumë të rregjistruara në vitin 2018.

Në vitin 2018, Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike janë rregjistruar 603. Në vitin 2017, Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike janë rregjistruar 436. Pra në vitin 2018, rezulton të jenë rregjistruar 16 % më shumë vepra penale se vitin e kaluar.


Në vitin 2018, janë rregjistruar 6 vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërore ndërkohë që në vitin 2017, kjo shifër është zero;

Në vitin 2018, Vepra penale kundër drejtësisë janë rregjistruar 77. Në vitin 2017, janë rregjistruar 139. Pra janë rregjistruar 28 % më pak vepra penale në vitin 2018, se vitin e kaluar.


Në vitin 2018, Vepra penale që çënojnë zgjedhjet e lira nuk ka pasur të rregjistruara ndërkohë që në vitin 2017 janë rregjistruar 10 të tilla.

Si në vitin 2018 ashtu edhe në vitin 2017, nuk ka pasur të rregjistruara vepra penale në lidhje me bandat e armatosura dhe organizatat kriminale dhe as ndonjë vepër penale të parashikuar në ligje të tjera.

# Viti 2018



# Viti 2017




## 9. Kriminaliteti sipas strukturës së kodit penal


### Raporti krime dhe kundravajtje

Më poshtë paraqitet analiza e strukturës së kriminalitetit për vitin 2018, sipas ndarjes në krime dhe kundravajtje penale që lidhen me procedimet penale të rregjistruara pranë organit të prokurorisë sipas veprave penale të parashikuara nga Kodi Penal.

#### Viti 2018




Ndërkohë për vitin 2017, siç shihet më poshtë rezulton:



### III. TREGUESIT STATISTIKORË 2 VJEÇARË SIPAS STRUKTURËS SË KODIT PENAL

#### 1. Proçedime penale të rregjistruara të reja

Proçedime të rregjistruara për vitin 2017 janë gjithsej 2271 proçedime penale ndërkohë që në vitin 2018 janë 2372 proçedime (pa u përfshirë procedimet penale të ardhura me transferim). **Pra vihet re një tendencë, në rritje e rregjistrimeve të proçedimeve penale, me një shifër prej 101 proçedime penale, apo 2 % më shumë se viti i kaluar.**



## 2. Treguesit statistikorë pasqyruar në tabela për veprat penale:

### Krime kundër jetës të kryera me dashje


KRIME KUNDËR JETËS ME DASHJE	2017					2018				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj. <sup>9</sup>	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 76 Vrasja <sup>10</sup>	2	2	1	2	0	5	0	1	0	2
Neni 77 Vrasja për një krim tjetër	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 78 Vrasja me paramendim	1	1	1	2	0	7	0	1	0	1 <sup>11</sup>
Neni 78/a Vrasje per gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 79 Vrasja në rrethana cilësuese	0	0	0	0	0	2	0	1	0	0
Neni 79/a Vrasja e funksionarëve publikë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 79/b Vrasja e punonjësve të Policisë së Shtetit	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 79/c Vrasja për shkak të marrëdhënieve familjare	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 80	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 81 Vrasja e foshnjës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 82 Vrasja në tronditje psikike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 83 Në kapërcim mbrojtjes nevojshe	0	2	0	2	2	0	0	0	0	0
Neni 83/a Kanosje për hakmarrje/ gjakmarrje	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0

<sup>9</sup> Ky tregues është totali i personave në hetim dhe të pandehur të regjistruar në organin e prokurorisë.


<sup>10</sup> Nuk janë përfshirë vrasjet e mbetura në tentativë (Per vitin 2017 numri i procedimeve per n. 76 – 22 i K.Penal, te cilat jane 5 çeshtje, 7 pandehur, numri i procedimeve te derguara per gjykim qe jane 2 dhe numri i te pandehurve derguar gjyqit 3 si dhe 4 të denuar. Nderkohe per vitin 2018 nuk jane shenuar numri i procedimeve per n. 76 – 22 të K.Penal që janë 7, numri i te pandehurve te regjistruar qe eshte 7, numri i ceshtjeve te derguara per gjykim qe eshte 3, numri i te pandehurve derguar per gjykim qe eshte 3 dhe numri i te denuarve per vitin 2018 qe eshte 1).

<sup>11</sup> Per 1 të pandehur është dhënë pafajësi.

Neni 83/b Nxitja për gjakmarrje	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 84 Kanosja	9	1	4	1	0	11	1	1	1	0
<b>Totali</b>	<b>13</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>7</b>	<b>2</b>	<b>25</b>	<b>1</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>3</b>




Të pandehur gjithsej për këto vepra penale, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar, si dhe disponimet e tjera për çështjet, si dhe të dëmtuarit, për dispozitat 76 – 84 të K.Penal, rezultojnë:




Raporti i vdekjeve të raportuara në vitin 2018 ka qenë 4, në krahasim me vitin e kaluar që kanë qenë 2.


Raporti femra meshkuj, raporti të mitur e të rritur, për të pandehurit, për vitin 2017 dhe 2018, referuar sa më sipër, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar, për dispozitat 76 – 84 të K.Penal:



Raporti femra, meshkuj, të rritur e të mitur, për të dëmtuarit, në të dy vitet:




Arsimim, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:



Vendbanimi, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:



Gjendja gjyqesore, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:






KRIME KUNDËR JETËS SHKAKTUAR ME PAKUJDESI	2017					2018				
	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 85 Vrasja nga pakujdesia	0	0	0	0	0	1	0	1 <sup>12</sup>	0	0
<b>Totali</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>


VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA ME DASHJE	2017					2018				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 86 Tortura	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 87 Tortura me pasoja te renda	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 88 Plagosje e rende me dashje	9	8	8	11	10	3	1	2	1	3
Neni 88/a Plagosje e rende ne gjendje te tronditjes se forte psiqike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 88/b Plagosje e rende me kapercim te kufijve te mbrojtjes se nevojshme	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 89 Plagosje e lehte me dashje	106	40	84	42	20	108	37	60	50	31 <sup>13</sup>
Neni 89/a Shitblerja e transplanteve	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 90 Demtime te tjera me dashje	0	0	0	0	0	3	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>115</b>	<b>48</b>	<b>92</b>	<b>53</b>	<b>30</b>	<b>114</b>	<b>38</b>	<b>62</b>	<b>51</b>	<b>34</b>

<sup>12</sup>Në këtë rast i pandehuri, është i gjinisë mashkull, i rritur, me arsim të mesëm, banues në zonë rurale, i padënuar më parë. I dëmtuari, është 1, i gjinisë mashkull, me pasojë vdekjen


<sup>13</sup> Gjithashtu për 7 të pandehur është vendosur pushimi I çështjes dhe për 1 të pandehur është dhënë pafajësi




Të pandehur gjithsej për këto vepra penale, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar, si dhe disponimet e tjera për çështjet, si dhe të dëmtuarit, për dispozitat 86 - 90 të K.Penal, rezultojnë:




Raporti plagosje e lehte dhe plagosje rëndë tek te demtuarit:




Raporti femra meshkuj, raporti te mitur e te rritur, per te pandehurit, per vitin 2017 dhe 2018, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar, për dispozitat 86-90 të K.Penal:




Raporti femra, meshkuj, të rritur e të mitur, për dy vitet për të pandehurit:




Arsimim, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:



Vendbanimi, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:




Gjendja gjyqesore, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:




VEPRA PENALE KUNDËR SHËNDETIT TË KRYERA NGA PAKUJDESIA	2017					2018				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 91 Plagosje e rëndë nga pakujdesia	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 92 Plagosja e lehtë nga pakujdesia	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>


VEPRA PENALE QË RREZIKOJNË JETËN DHE SHËNDETIN NGA NDËRPRERJA E SHTATZANISË OSE NGA MOSDHËNIA E NDIHMËS	2017					2018				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 93 Ndërprerja e shtatzanisë pa pëlqim të gruas	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 94 Ndërprerja e shtatzanisë e kryer në vende dhe nga persona të paautoriz.	1	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 95 Dhënia e mjeteve për ndërprerjen e shtatzanisë	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 96 Mjekimi i pakujdesshëm	3	2	0	4	1	2	2	0	3	0
Neni 97 Mosdhënia ndihmë	0	0	0	0	0	2	0	0	0	0
Neni 98 Mosdhënia e ndihmës nga kapiteni i anijes	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 99 Shkaktimi i vetëvrasjes	28	0	0	0	0	69	0	0	0	0
<b>Totali</b>	<b>32</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>4</b>	<b>1</b>	<b>73</b>	<b>2</b>	<b>0</b>	<b>3</b>	<b>0</b>




Të pandehur gjithsej për këto vepra penale, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar, si dhe disponimet e tjera për çështjet, si dhe të dëmtuarit, për dispozitat 93 - 99 të K.Penal, rezulton:




Në vitin 2018, janë raportuar 95 të dëmtuar/viktima, konkretisht 42 meshkuj të rritur dhe 53 femra të rritura. Janë raportuar në vitin 2018, edhe 89 vdekje. Në vitin 2017, nuk ka raportime për të dëmtuarit. Raporti femra meshkuj, raporti te mitur e te rritur, per te pandehurit, per vitin 2017 dhe 2018, referuar në total, përfshirë edhe numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar, për dispozitat 93-99 të K.Penal:




Arsimim, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:



Vendbanimi, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:




Gjendja gjyqesore, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:




KRIME SEKSUALE	2017					2018				
	Nr. Procd. Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj.	Nr. Pand. Per gjykim	Nr. Pand denuar	Nr. Procd Regj	Nr. procd per gjykim	Nr. i pand. Regj	Nr. Pand per gjykim	Nr. Pand denuar
Neni 100 M. Sek/ homoseksuale me të mitur	4	3	2	3	1	0	0	0	0	2
Neni 101 M. Sek/ homoseksuale me dhunë me të mitur të moshës me 14-18 vjeç	0	0	0	0	0	2	0	2	0	0
Neni 102 M. Seksuale me dhunë me të rritur	3	0	1	0	1	2	0	1	0	0
Neni 102/a M. Homoseksuale me dhunë me të rritur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 103 M. Sek/ homoseksuale me persona te pazotë për t'u mbrojtur	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 104 Marrëdhënie seksuale ose homoseksualeme kërcënim me përdorimin e armës	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 105 M. Sek/ homoseksuale duke shpërdoruar detyrën	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 106 M. Sek/ homoseksuale me persona në gjini ose në	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0

kujdestari										
Neni 107 M. Sek/ homoseksuale ne vende publike	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Neni 108 Vepra të turpshme	3	3	3	3	1	3	2	1	3	3
Neni 108/a Ngacmimi seksual	0	0	0	0	0	3	2	3	2	0
<b>Totali</b>	<b>10</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>6</b>	<b>3</b>	<b>10</b>	<b>4</b>	<b>7</b>	<b>5</b>	<b>5</b>




Të pandehur gjithsej në total përfshirë edhe numrin nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar si dhe të dëmtuarit, për dispozitat 100-108/a të K.Penal:




Për të dëmtuarit në vitin 2018 nuk janë raportuar të dhëna.


Raporti femra meshkuj, raporti te mitur e te rritur, per te pandehurit, per vitin 2017 dhe 2018, përfshirë në total numri edhe nga çështjet e mbartura nga viti i kaluar, për dispozitat 100 – 108/a të K.Penal:



Arsimim, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:



Vendbanimi, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:




Gjendja gjyqesore, per vitin 2017 dhe 2018 per te pandehurit:






- Mbi 6 muaj deri në 9 muaj për 6 çështje, me 6 të pandehur, me 1 të arrestuar.

#### Viti 2018:



#### **4. Të dhëna sociale dhe demografike për të pandehurit**

**Persona nën hetim dhe të pandehur, të vitit 2018 dhe ata që janë mbartur nga vitet e kaluara:**

Të pandehur gjithsej **për vitin 2018** kanë qenë 1517 persona nga të cilët 1422 meshkuj dhe 95 femra (përfshirë të pandehurit e mitur). Sipas veprave penale kanë qenë të ndarë në këtë mënyrë:

- **690** për vepra penale kundër **autoritetit të shtetit** (669 meshkuj dhe 21 femra)
- **453** për vepra penale **në sferën ekonomike dhe kundër pasurisë** (419 meshkuj dhe 34 femra);
- **278** për vepra penale kundër **jetës dhe personit** (245 meshkuj dhe 33 femra);
- **85** për vepra penale kundër **drejtësisë** (78 meshkuj e 7 femra);
- **11** për vepra penale kundër **mjedisit** (meshkuj);

#### **Te pandehurit sipas gjinise për vitin 2018:**

Në raport të **përkatësisë gjinore** gjithsej kanë qenë **1422 meshkuj dhe 95 femra**.

#### **Te pandehurit sipas shtetësisë për vitin 2018:**

Janë marrë me cilësinë e të pandehurit edhe **13 shtetas të huaj**.

- 5 për nenin 143 të Kodit Penal;
- 2 për nenin 203/1 të K.Penal;
- 1 për nenin 283/1 të K.Penal;
- 2 për nenin 287/1 të K.Penal;
- 3 për nenin 290 të K.Penal;

#### **Te pandehurit sipas arsimit për vitin 2018:**

Pjesa më e madhe e të pandehurve rezulton të kenë arsim deri në 9 klasë, e ky fakt evidentohet me numrin e të pandehurve që kanë këtë arsim, i cili është 1059, ndërkohë të pandehurit me arsim të mesëm janë 350 e ata me arsim të lartë janë 108.

#### **Te pandehurit sipas banimit për vitin 2018:**

Pjesa më e madhe e të pandehurve evidentohet të jenë banorë të qytetit, konkretisht 909 të pandehur e 608 banojnë në zonat rurale.

#### **Recidivistë në vitin 2018:**

Recidivistë të njëjtë janë 2 të pandehur, recidivistë të ndryshëm janë 125 të pandehur dhe të padënuar janë 1390 të pandehur.

## 5. Të dhëna për të mitur për vitin 2018


Për vitin 2018, rezultojnë të jenë **mosfilluar 61 çështje penale, me të dyshuar apo të dëmtuar të mitur, si vijon:**

- **15 për largim banese;**
- **Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike, gjithsej 12 çështje:**
  - 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i K.Penal;
  - 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 279 i K.Penal;
  - 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 289 i K.Penal;
  - 8 për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i K.Penal;
  - 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal;
- **Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, gjithsej 10 çështje:**
  - 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 124 i K.Penal;
  - 3 për veprën penale të parashikuar nga neni 125 i K.Penal;
  - 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 126 i K.Penal;
  - 3 për veprën penale të parashikuar nga neni 127 i K.Penal;
  - 2 për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i K.Penal;
- **Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, gjithsej 9 çështje:**
  - 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal;
  - 8 për veprën penale të parashikuar nga neni 90 i K.Penal;
- **Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, gjithsej 8 çështje:**
  - 7 për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i K.Penal;
  - 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 150 i K.Penal;
- **3 për mungesë të elementëve të veprës penale.**
- **Vepra penale kundër jetës, gjithsej 1 çështje:**
  - 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 84 i K.Penal;
- **Krime seksuale, gjithsej 1 çështje:**
  - 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i K.Penal;
- **Vepra penale kundër lirisë së personit, gjithsej 1 çështje:**
  - 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 112 i K.Penal;



➤ **Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, gjithsej 1 çështje:**

- 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 119 i K.Penal;



Për vitin 2018 janë **rregjistruar 127 çështje penale me 75 persona nën hetim, me të dyshuar apo të dëmtuar të mitur:**

➤ **Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, gjithsej 33 çështje, me 16 të pandehur:**

- 28 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 134 i K.Penal me 14 të pandehur;
- 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 140 i K.Penal, me 1 të pandehur;
- 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 183 i K.Penal me 1 të pandehur;
- 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 186/a i K.Penal;
- 2 çështje penale për veprën penale të shpërdorimit të detyrës;


➤ **Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike, gjithsej 30 çështje, me 21 të pandehur:**

- 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 262 i K.Penal;
- 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 273 i K.Penal;
- 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 274 i K.Penal;
- 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 275 i K.Penal;

- 2 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 278 i K.Penal, me 2 të pandehur;
  - 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 283 i K.Penal;
  - 10 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 290 i K.Penal me 6 të pandehur;
  - 13 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 291 i K.Penal, me 13 të pandehur;
- **Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, gjithsej 30 çështje, me 21 të pandehur:**
- 6 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 124 i K.Penal, me 2 të pandehur;
  - 2 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 124/a i K.Penal;
  - 2 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 124/b-1 i K.Penal;
  - 20 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i K.Penal, me 19 të pandehur;
- **Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, gjithsej 16 çështje, me 12 të pandehur:**
- 1 çështje për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i K.Penal;
  - 15 çështje për veprën penale të parashikuar nga neni 89 i K.Penal, me 12 të pandehur;
- **Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës, gjithsej 10 çështje:**
- 1 çështje për veprën penale të parashikuar nga neni 96 i K.Penal;
  - 9 çështje për veprën penale të parashikuar nga neni 99 i K.Penal;
- **Krime Seksuale, gjithsej 5 çështje, me 3 të pandehur:**
- 2 çështje për veprën penale të parashikuar nga neni 100 i K.Penal, me 1 të pandehur;
  - 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 101 i K.Penal, me 1 të pandehur;
  - 2 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 108 i K.Penal, me 1 të pandehur;
- **Krime kundër jetës të kryera me dashje, gjithsej 1 çështje, me 1 të pandehur;**
- 1 çështje për veprën penale të parashikuar nga neni 76-22 i K.Penal, me 1 të pandehur;
- **Vepra penale kundër sekretit dhe kufijve shtetërorë, gjithsej 1 çështje:**
- 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 297 i K.Penal;

➤ **Vepra penale kundër drejtësisë, gjithsej 1 çështje, me 1 të pandehur:**

- 1 çështje penale për veprën penale të parashikuar nga neni 321 i K.Penal, me 1 të pandehur;



**Të pandehurit e mitur, kanë qenë gjithsej 39, për këto vepra penale:**

➤ **Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, 17 të pandehur:**

- 14 për nenin 134 të K.Penal;
- 1 për nenin 140 të K.Penal;
- 1 për nenin 150 të K.Penal;
- 1 për nenin 183 të K.Penal;

➤ **Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë publike, 15 të pandehur:**

- 2 për nenin 278 të K.Penal;
- 13 për nenin 291 të K.Penal;

➤ **Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, 4 të pandehur:**

- 4 për nenin 89 të K.Penal;

➤ **Krime kundër jetës të kryera me dashje, 1 i pandehur:**


- 1 për nenin 76 – 22 të K.Penal;

➤ **Krime seksuale, 1 i pandehur:**

- 1 për nenin 108/1 të K.Penal;


➤ **Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, 1 i pandehur:**

- 1 për nenin 130/a/1 të K.Penal;



**Gjinia e të pandehurve të mitur:** Të pandehur të mitur rezultojnë të jenë të gjinisë mashkull.

**Mosha e të pandehurve:** Të pandehurit e mitur rezultojnë të jenë 7 të grup moshës nën 14 vjeç; 9 të grupmoshës 14 – 16 vjeç dhe 23 të grup moshës 16 – 18 vjeç.



#### Masat e sigurimit:

Për 2 të pandehur të mitur është caktuar masa e sigurimit arrest në burg, për veprën penale të vjedhjes dhe për 1 të pandehur është caktuar masa e sigurimit arrest në shtëpi për veprën penale të parashikuar nga neni 76 – 22 i K.Penal.

Për 7 të pandehur janë vendosur masa të tjera shtrënguese.

#### Pushimi i çështjeve:

Janë pushuar me ndërmjetësim 5 çështje penale, me 2 të pandehur (4 për nenin 89 të K.Penal; 1 për nenin 90 të K.Penal);

Janë pushuar për shkaqe të tjera 36 çështje, me 17 të pandehur.

#### Dërgimi për gjykim:

Janë dërguar për gjykim 34 çështje me 38 të pandehur, nga të cilat rezulton se është pranuar kërkesa për dërgimin në gjyq në 30 çështje, është pushuar në 15 çështje dhe janë kthyer aktet për 1 çështje.

### **Kërkesat për dënim:**

Është kërkuar në 23 raste dënimi me burgim dhe nga gjykata është dhënë në po kaq raste. Në 1 rast është dhënë edhe dënim plotësues. Praktika e dënimit për të pandehurit e mitur ka qenë aplikimi i nenit 59 ose 63 të K.Penal.

**Pezullimet:** Janë pezulluar 11 çështje.

**Transferuar:** Janë transferuar 4 çështje.

## **6. Të dhënat për pasojat e veprave penale**


### **6.1. Pasojat e veprave penale për të dëmtuarit e rritur**

Në vitin 2018 rezulton të kenë qenë të dëmtuar 298 shtetas të rritur.


Në vitin 2017 janë raportuar 21 vdekje, 39 plagosje të rënda dhe 111 plagosje të lehta. Ndërkohë në vitin 2018, janë raportuar 119 vdekje, 20 plagosje të rënda dhe 67 plagosje të lehta.

Në përqindje *pasojat e veprave penale* për të dyja vitet paraqiten si vijon:

**2017**





**2018**



Sipas *gjinisë*, të dëmtuarit në vitin 2018, rezultojnë 154 femra dhe 144 meshkuj. Në përqindje sipas gjinisë të dëmtuarit janë si vijon:

**2017**

**2018**



## 6.2. Pasojat e veprave penale për të dëmtuarit e mitur

Në vitin 2018 rezulton të kenë qenë të dëmtuar 129 shtetas të mitur dhe 25 kanë qenë dëshmitarë.

Sipas veprave penale ndahen në këtë mënyrë **të dëmtuarit**:

### ➤ Vepra penale kundër fëmijëve, martesës dhe familjes, 32 persona:

- 12 për nenin 124 të K.Penal;
- 2 për nenin 124/b të K.Penal;
- 4 për nenin 125 të K.Penal;
- 3 për nenin 127 të K.Penal;
- 11 për nenin 130/a të K.Penal;

### ➤ Vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit, 25 persona:

- 1 për nenin 88 të K.Penal;
- 14 për nenin 89 të K.Penal;
- 10 për nenin 90 të K.Penal;

### ➤ Vepra penale kundër rendit dhe sigurisë juridike, 21 persona:

- 1 për nenin 273 të K.Penal;
- 1 për nenin 275 të K.Penal;
- 1 për nenin 289 të K.Penal;
- 15 për nenin 290 të K.Penal;
- 3 për nenin 291 të K.Penal;

### ➤ Vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike, 18 persona:

- 16 për nenin 134 të K.Penal;
- 1 për nenin 140 të K.Penal;
- 1 për nenin 186/a të K.Penal;

### ➤ 13 për largim nga banesa;

➤ **Vepra penale që rrezikojnë jetën dhe shëndetin nga ndërprerja e shtatzanisë ose mosdhënia e ndihmës, 10 persona:**

- 1 për nenin 96 të K.Penal;
- 9 për nenin 99 të K.Penal;

➤ **Krime seksuale, 6 persona:**

- 3 për nenin 100 të K.Penal;
- 1 për nenin 101/2 të K.Penal;
- 2 për nenin 108 të K.Penal;


➤ **2 për mungesë vepre penale.**

➤ **Vepra penale kundër moralit dhe dinjitetit, 1 person:**

- 1 për nenin 119 të K.Penal;

➤ **Vepra penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga punonjësit shtetërorë ose në shërbim publik, 1 person:**

- 1 për nenin 248 të K.Penal;



**Dëshmitarët e mitur**, sipas veprave penale ndahen në këtë mënyrë:

- 5 për nenin 130/a të K.Penal;
- 4 për largim nga banesa;
- 3 për nenin 89 të K.Penal;
- 2 për nenin 112 të K.Penal;
- 2 për nenin 124/a të K.Penal;
- 2 për nenin 290 të K.Penal;
- 2 për nenin 321 të K.Penal;
- 1 për nenin 84 të K.Penal;
- 1 për nenin 126 të K.Penal;
- 1 për nenin 140 të K.Penal;
- 1 për nenin 274 të K.Penal;
- 1 për mungesë të veprës penale.

## **V. Të dhëna lidhur me marrëdhëniet juridiksionale me autoritetet e huaja**

### **1. Ekstradime**

Rezulton të jenë kryer 5 ekstradime, për personat në kërkim ndërkombëtar nga autoritetet e huaja.

- 2 për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 114 i K.Penal;
- 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 88 i K.Penal;
- 1 për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 283/2 të K.Penal;
- 1 për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 125 i K.Penal;

Rezulton të mos jenë kryer 2 ekstradime, për person në kërkim ndërkombëtar nga autoritet e huaja:

- 1 për veprën penale të parashikuar nga neni 143/2 i K.Penal, me arsyetimin se kishte një procedim penal në Shqipëri. Është ankimuar.
- Nuk është kryer 1 ekstradim për veprat penale kundër pasurisë. Megjithëse nga gjykata është njohur vendimi penal, nuk është ekzekutuar për shkak të parashkrimit të ekzekutimit.

Ndërkohë rezulton që nga ana e prokurorisë sonë të jetë bërë 1 kërkesë për ekstradim të një të dënuari, kërkesë e drejtuar autoriteteve greke, e cila është refuzuar nga këto të fundit, me arsyetimin se personi e ka kryer veprën penale në shtetin grek. Atëherë nga prokuroria jonë është proceduar me kërkesë për njohjen e vendimit penal shqiptar të dënimit në shtetin grek.



## **2. Letër porositë**

*Letër porosi nga jashtë shtetit* ka pasur gjithsej 46, nga të cilat rezulton të jenë ekzekutuar 17, të kenë qenë të pamunduara për t'u ekzekutuar pavarësisht veprimeve të prokurorit dhe gjykatës 8 të tilla, dhe në fazë ekzekutimi rezultojnë të jenë 21 kërkesa. Më specifikisht sipas objektit letër porositë nga jashtë shtetit i pasqyrojmë si vijon:

*Komunikim aktesh, gjithsej 27 letër porosi:* 8 të ekzekutuara; 7 të mos ekzekutuara; 12 të papërfunduara.

*Njoftim për paraqitje, gjithsej 5 letër porosi:* 2 të ekzekutuara; 3 të papërfunduara.

*Njoftim aktesh, gjithsej 1 letër porosi:* 1 e papërfunduar.

*Video konferencë, gjithsej 5 letër porosi:* 1 të ekzekutuara; 1 të mos ekzekutuara; 3 të papërfunduara.

*Pyetje të pandehuri, gjithsej 1 letër porosi:* 1 e papërfunduar.

*Njoftim në cilësinë e dëshmitarit, gjithsej 3 letër porosi:* 3 të ekzekutuara;

*Njoftim për t'u paraqitur si i pandehur, gjithsej 3 letër porosi:* 3 të ekzekutuara;

*Komunikim aktesh për dënim, gjithsej 1 letër porosi:* 1 e papërfunduar.

*Letër porosi të dërguara nga prokurët e kësaj prokurorie, në drejtim të shteteve të huaja, rezulton të jenë 21 të tilla, kryesisht për veprat penale si më poshtë vijon:*

- 9 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër pasurisë dhe në sferën ekonomike;
- 7 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi vepra penale kundër jetës dhe personit;
- 5 kërkesa për ndihmë juridike me objekt hetimi krime kundër autoritetit të shtetit;

## **3. Njohjet e vendimeve penale**

*Kërkesa për njohje vendimesh penale të huaja* rezulton të kenë qenë 6 të tilla.

Janë njohur 5 vendime penale të huaja.

- 2 për n. 283 të K.Penal;

- 1 për n. 323 dhe 134/2 të k.penal
- 1 për n. 114/2 të K.Penal;
- 1 për n. 283/a/2 dhe 297 të K.penal

#### **4. Transferimet e procedimeve penale**

Rezultojnë të jenë transferuar nga autoritetet e huaja 5 çështje të cilat janë rregjistruar si procedime penale në prokurorinë tonë e konkretisht:

- 4 çështje nga autoritetet sllovene (2 për nenin 189/1 të K.Penal; 1 për nenin 186/1 të K.Penal dhe 1 për nenin 190 të K.Penal);
- 1 çështje nga autoritetet franceze (1 për nenin 130/a/1 dhe 134 të K.Penal).

#### **5. Shpalljet në kërkim ndërkombëtar dhe heqjet nga kërkimi ndërkombëtar**

Janë kryer shpallje në kërkim ndërkombëtar:

- 5 për nenin 186 të K.Penal;
- 4 për nenin 283 të K.Penal;
- 2 për nenin 76 të K.Penal;
- 1 për nenin 143 të K.Penal;
- 1 për nenin 145 të K.Penal;
- 1 për nenin 290 të K.Penal;
- 1 për nenin 130/a të K.Penal;
- 1 për nenin 248 të K.Penal;
- 1 për nenin 187 të K.Penal;

Janë hequr nga kërkimi ndërkombëtar:

- 3 për nenin 76 të K.Penal, pasi është parashkruar ekzekutimi i dënimit;
- 2 persona të shpallur në kërkim në vitet 2011 dhe 2013,
- 1 për nenin 290 të K.Penal, pasi ka vdekur personi;
- 1 për nenin 186 të K.Penal, pasi është kapur dhe i ka nisur vuajtja e dënimit;
- 1 për nenin 89 të K.Penal,
- 1 për nenin 245 të K.Penal,
- 1 për nenin 321/2 të K.Penal

#### **VI. Të dhëna për ngarkesën e punës për çdo prokuror dhe oficer të policisë gjyqësore**

Ju lutem në lidhje me këtë moment, shihni tabelat bashkalidhur.

## VII. Informacion mbi administrimin e prokurorisë


### 1. Organika e Prokurorisë:

Ne vitin 2018, stafi i kësaj prokurorie, përbëhet nga 50 punonjës (1 sekretare është shtuar në organikë). Numri i prokurorëve është 25. Puna e prokurorëve është ushtruar nën drejtimin e drejtuesit të kësaj prokurorie i cili ndihmohet nga 1 zëvendës drejtues si dhe drejtuesit e seksioneve.

#### Tabelë organike numerike e prokurorisë për vitin 2018

**Emërtimi      Organika      Fakti      Meshkuj      Femra**

Drejtuës	1	1	0	1
Zv/Drejtuës	1	1	1	0
Prokurorë	23	19	11	8
Gjithsej	25	21	12	9



Në vitin 2016, 1 prokuror (ish Drejtuesi i kësaj prokurorie), është larguar për të ushtruar funksionet me komandim, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Gjatë vitit 2017, 1 prokuror, është larguar për të ushtruar funksionet me komandim, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në vitin 2018 rezulton të jetë larguar sërish 1 prokuror, për të ushtruar funksionet me komandim, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Në vitin 2018 rezulton të jenë larguar 2 prokurorë, për të ushtruar funksionet e Drejtuesit, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë.


Në vitin 2018, rezulton të jetë caktuar përkohësisht për të ushtruar funksionet në prokurorinë tonë, 1 prokurorë.

Policia gjyqësore pranë kësaj Prokurorie, në përbërjen e saj ka pasur gjithsej 10 oficerë policie gjyqësore, por që në vijim për shkak të ndryshimeve në organikë kanë ngelur 8 oficerë të policisë

gjqësore. Ndërkohë që 1 vend është i paplotësuar, për shkak të largimit nga detyra të 1 oficeri të policisë gjyqësore.

### Tabelë organike numerike e policisë gjyqësore


Numri	Organika	Efektivë	Meshkuj	Femra
OPGJ	8	7	4	3



Personeli administrativ vepron në krah të prokurorëve dhe ndihmon në prodhimin, administrimin e të gjithë dokumentave apo në shërbime të tjera të domosdoshme për punën tonë. Numri i përgjithshëm i personelit administrativ, duke përfshirë Kancelaren, kryesekretaren, kryetaren e degës së buxhetit, sekretare si edhe punonjësit në shërbimet ndihmëse si shoferë, punonjës shërbimi, sanitare, administrator rrjeti, në vitin 2018 ka qene 15, nga të cilët 10 femra dhe 5 meshkuj.

### Tabele organike numerike e administratës

Funksioni	Organika	Meshkuj	Femra
Kancelare	1	0	1
K/Sekretare	1	0	1
K/Deges Buxhetit	1	0	1
Sekretare	7	1	6
Shofer	3	3	0
Portier	1	1	0
Sanitare	1	0	1
Gjithsej	15	5	10



## 2. Raporti Financiar

Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan gjatë vitit 2018 për ushtrimin e veprimtarisë ekonomike–financiare janë çelur fondet:

Fondi	Plan	Fakt	Realizimi
Fondi i Pagave 600	64,831,780	64,815,307	99.98 %
Fondi i sigurimeve Shoq.Shëndt.	8,973,960	8,923,579	99.4 %
Fondi i shpenzimeve materiale	15,750,000	15,749,863	100 %
Fondi transferta korrente te brendshme	80,000	80,000	100 %
Fondi investimeve	851,000	795,000	93.4 %

Realizimi i fondeve është në masën 98,6 %.

Shpenzime procedurale të arkëtuara nga Prokuroria janë **208,620** lekë të cilat janë derdhur në buxhetin e shtetit.

Totali i pagesës së orëve të gatishmërisë për prokurorët është në shumën prej **5,709,000** lekë. Totali i pagesës së mbikohës të punës për prokurorët është **622,700** lekë.

## 3. Çështje të tjera mbi administrimin e Prokurorisë

Me Urdhërin nr. 1 datë 17.02.2017 „Për miratimin e rregullores së organizimit dhe funksionimit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan“, Drejtuesi i kësaj prokurorie, ka urdhëruar miratimin e rregullores përkatëse, e cila rezulton aktualisht të jetë në fuqi. Për shkak të ndryshimeve organike apo përshtatjes së punës, vazhdimisht ka pasur urdhëra të Drejtuesit të Prokurorisë, që ka vendosur ndarje detyrash ndërmjet punonjësve të administratës apo duke u ngarkuar edhe oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve me punë administrative.

Përsa i përket rregullimit të marrëdhënieve me publikun, që në vitin 2017, është miratuar nga Drejtuesi i asaj kohe, Urdhëri nr. 02 datë 06.03.2017 „Për shërbimin e marrëdhënieve me publikun në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan“ është urdhëruar caktimi i prokurorit që drejton dhe mbikqyr shërbimin e marrëdhënieve me publikun si dhe nëpunësja e marrëdhënieve me publikun dhe koordinatorë në përputhje me ligjin për të drejtën e informimit. Të dy personat e ngarkuar rakordojnë me prokurorin e çështjes në rastet kur kërkohet informacion për çështje në hetim apo në gjykim para se të japin përgjigje, pasi marrin edhe miratimin e Drejtuesit të Prokurorisë.

Në lidhje me kërkesat për informim rezulton të jetë ekzistues regjistri i kërkesave të bëra në mbështetje të ligjit të sipërcituar, në të cilin shënohen kërkesat dhe kthimi i përgjigjes, sipas rubrikave përkatëse.

Përsa i përket mbajtjes së regjistrave, rezulton se përgjithësisht është kryer një punë e mirë në drejtim të mbajtjes së pasqyrimin të të dhënave në sistemin manual dhe atë elektronik. Ka edhe disa mospërputhje me faktin, të cituara në këtë raport, gjë e cila ka ndodhur për shkak të mosraportimit në kohën e duhur nga prokurorët.

Siç edhe u citua në pjesën e mësipërme të këtij raporti, vazhdimisht nga Drejtuesi i Prokurorisë, janë nxjerrë udhëzimet përkatës, për mbledhjen e të dhënave statistikore për çështje të vlerësuara të një kategorie të veçantë. Këto udhëzime rezultojnë të mos jenë zbatuar, pasi prokurorët paraqesin ankesa në lidhje me ngarkesën e tyre përse i përket hetimit dhe përfaqësimit në gjykim të çështjeve penale. Duke qenë se punonjësit e administratës, janë ngarkuar me punë të ndryshme, në fakt edhe prej tyre, shpesh gjendet e vështirë për t'i ngarkuar me mbledhjen e të dhënave statistikore për çështje të caktuara, sipas udhëzimeve.

Rregjistrat mbahen dhe plotësohen nga punonjës të administratës dhe në disa raste nga oficerë të policisë gjyqësore të seksioneve, për shkak të ngarkesës së punës së punonjësve të administratës.

Me udhëzimin nr. 4 datë 12.01.2018 „Për organizimin dhe koordinimin e punës në Prokurori, lidhur me ecurinë e procedimeve penale“ Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, ka parashikuar mënyrën e kërkimit të informacionit për ecurinë e çdo procedimi penal nga prokurorët e seksioneve si dhe drejtuesi i seksionit respektiv, detyrimin e prokurorëve të informojnë drejtuesin e seksionit dhe drejtuesin e prokurorisë sa herë që kërkohet nga këta të fundit në lidhje me ecurinë e një çështje të caktuar si në fazën e hetimeve paraprake, për vendimmarrjen dhe për probleme të tjera që mund të lindin gjatë procedimit, gjatë gjykimin të çështjeve në themel, gjykimin të çështjeve të veçanta (kundërshtim vendim mosfillimi) dhe në fazën e ekzekutimit të vendimeve penale. Nga Drejtuesi i Prokurorisë është proceduar herë pas here me dhënie udhëzimesh jo të detyrueshme për çështje të veçanta. Në pjesën më të madhe këto udhëzime janë zbatuar.

Me Udhëzimin nr. 9 datë 25.01.2018 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka ndërmarrë masa për disiplinimin e mënyrës për formimin e fashikujve të gjykimin dhe të prokurorit në përfundim të hejtimeve, krijimin e një praktike të njehsuar për mënyrën e renditjes së akteve për të gjitha procedimet në hetim, sigurimin e respektimit të parimeve të një procesi të drejtëm, të barbartë dhe të rregullt ligjor.

Është nxjerrë urdhëri nr. 31 Prot datë 30.04.2018 „Për organizimin dhe funksionimin e Seksioneve në Prokurorinë pranë Gjykatës së shkallës së Parë Elbasan“ i cili në periudha të ndryshme ka pësuar ndryshime, për shkak të lëvizjeve në organikë që ka pasur kjo prokurori. Seksionet e kësaj prokurorie, në varësi të numrit të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, kanë pësuar ndryshime, për shkak të largimit të punonjësve dhe ky fakt në të vërtetë është pasqyruar edhe në ngadalesimin e punës.

Me Udhëzimin nr. 32 prot datë 30.04.2018 „Për shpërndarjen e çështjeve në prokurori dhe hedhjen e të dhënave në sistemin elektronik“ Drejtuesi i Prokurorisë ka udhëzuar mënyrat e monitorimit të procesit të shpërndarjes së çështjeve me qëllim sigurimin e paanshmërisë, pavarësinë dhe efikasitetin e punës dhe disiplinimin e rasteve kur prokurori vendos refuzimin e marrjes së materialit. Shorti elektronik funksionon rregullisht, megjithëse konstatohet se vetë ai nuk bën një shpërndarje të barbartë të çështjeve mes prokurorëve dhe për këtë shkak Drejtuesi i Prokurorisë shpesh herë ndërkohë që prokurorët paraqesin ankesa në lidhje me plotësimin e të dhënave në sistemin CAMS, duke pretenduar ngadalësi të këtij sistemi, ngarkesë në hetimin dhe përfaqësimin e çështjeve në gjykatë.

Me Udhëzimin nr. 33 prot datë 30.04.2018 „Për respektimin e standarteve të etikës, rregullat e sjelljes dhe disiplinës në punë“ nga Drejtuesi i Prokurorisë, me qëllim disiplinimin e monitorimit, respektimit të orarit të punës dhe qëndrimit në detyrë si dhe respektimin e rregullave të etikës, janë nxjerrë disa udhëzime specifike.

Me Udhëzimin nr. 65 prot datë 29.10.2018 „Për sistemin e provave materiale“ Drejtuesi i Prokurorisë ka ngritur një grup pune për sistemin e provave materiale, me qëllim identifikimin e tyre në mënyrë sa më të shpejtë e të rregullt, pasur parasysh që Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në fund të vitit 2017 është transferuar në një godinë të re dhe administron edhe arkivën apo materiale të Prokurorisë që tashmë nuk janë më, si ajo e Librazhdit apo Gramshit. Aktualisht provat materiale janë sistemuar.

## **VIII. DREJTIMET DHE PËRPARËSITË NË LUFTËN KUNDËR KRIMINALITETIT PËR VITIN PASARDHËS DHE REKOMANDIME**

### ***Garantimi i pavarësisë së prokurorit:***

Në lidhje me marrjen e masave për respektimin e standarteve etike dhe profesionale në funksion të forcimit të integritetit të prokurorëve, do të ishte me vend, mosndryshimi i herë pas hershëm i prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore, në seksionet e ngritura pranë kësaj prokurorie, me qëllim, mundësimin e specializimit të prokurorëve sipas seksioneve përkatëse, në fusha të caktuara. Kjo do të sillte detyrimisht rritjen e tyre profesionale dhe pasoja të drejtëpërdrejta në hetimet e çështjeve.

Prokurorët rezultojnë t'i nënshtrohen Programit të Trajnimit Vazhdues për prokurorët dhe gjyqtarët, të Shkollës së Magjistraturës, ndërkohë që oficerët e policisë gjyqësore të Seksioneve, nuk janë pjesë e këtij programi. Trajnimet për ta janë shumë të pakta dhe jo të gjithë kanë pasur mundësinë e nënshtimit ndaj trajnimeve gjatë vitit që kaloi. Për këtë shkak gjendet me vend, që të organizohen trajnime për oficerët e policisë gjyqësore duke kërkuar ndihmën e partnerëve.

Prokurorët, gëzojnë pavarësinë në çështjet penale konkrete, por në respektim të ligjit nr. 97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndërmerren hapat për nxjerrjen e udhëzimeve jo të detyrueshme për çështjet penale. Në lidhje me këtë moment, është i domosdoshëm një udhëzim i përgjithshëm i Prokurorit të Përgjithshëm, pasi ndodhur para ndryshimeve të reja legjislativë, pavarësia e prokurorit mund të keqkuptohet, nga vetë prokurorët apo edhe drejtuesit. Duhet të arrihet të bëhet dallimi mes pavarësisë që karakterizon gjyqtarin nga pavarësia e prokurorit. Deri para ndryshimeve të ndodhura në Kodin e Procedurës Penale dhe në ligjet përkatëse, prokuroria ka funksionuar si një sistem hierarkik dhe për këtë shkak, ekziston nevoja e trajnimeve dhe rregullimi në mënyrë më të detajuar i marrëdhënieve mes drejtuesit të prokurorisë dhe prokurorëve.

Përsa i përket, respektimit të standarteve të etikës, rregullave të sjelljes dhe disiplinës në punë, jemi munduar të marrim masa, duke qenë se Prokuroria e Elbasanit, ushtron funksionet në një godinë të re dhe eshte e pajisur me infrastrukturen perkatese per te pasur nen vezhgim levizjet e

punonjesve. Megjithatë duhet rritur ndërgjegjësimi tek prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore, edhe në këtë drejtim.

Në lidhje me marrjen e masave për rritjen profesionale dhe specializimin e prokurorëve për njohje dhe zbatim të legjislacionit penal për të miturit, mendojmë se jemi duke ecur në hapat e duhur. Prokurorët i janë nënshtruar trajnimeve të duhura. Pasur parasysh numrin e vogël të rasteve, me të dëmtuar apo autorë të mitur, në krahasim me çështjet e tjera të rregjistruara në këtë prokurori, në të vërtetë Seksioni për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale me të dëmtuar apo autore të mitur, në Prokurorinë tonë është i njëjtë me Seksionin për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhënieve juridiksionale. Do të ishte me vend, nëse do të plotësohej organika, që ky seksion të ndahej në dy pjesë, pra në Seksionin për hetimin dhe përfaqësimin në gjykim të veprave penale me të dëmtuar të mitur dhe autorë të mitur dhe në Seksionin për ekzekutimin e vendimeve penale dhe marrëdhënieve juridiksionale me jashtë.

Përsa i përket marrjes së masave për forcimin e rolit aktiv të prokurorit në hetimin paraprak, në funksion të shtimit të rasteve të hetimeve të filluara kryesisht nga vetë organi i prokurorisë, bëjmë me dije se, rastet mbeten të pakta, për shkak edhe të faktit se materialet referohen thuajse menjëherë nga aktorë të tjerë, kryesisht policia gjyqësore. Do të ishte me vend, pasja e një punonjësi, si pjesë e Zyrës së Marrëdhënieve me publikun, që të ishte vazhdimisht i azhurnuar me të dhënat e ofruara nga media, në mënyrë që të kishim mundësi për nisjen kryesisht të çështjeve penale. Megjithatë nuk mund të themi se kanë mbetur pa u hetuar çështje penale, pasi rezultoni se referimet janë kryer nga agjensitë e tjera ligjzbatuese.

Në lidhje me zbatimin e teknikave speciale të hetimit, konstatojmë se më tepër përdoret mjete i kërkimit të provës, përgjimi. Në lidhje me veprimet simuluese, duhet një punë më këmbëngulëse e prokurorit dhe një bashkëpunim më i madh i policisë gjyqësore, meqenëse kërkoni bindjen e qytetarëve për të bashkëpunuar dhe burime njerëzore të cilat do të ishte mirë të ishin të ndryshëm nga policia vendore, për shkak të riskut që mbart identifikimi i këtyre të fundit në qarkun ku ushtrojnë funksionet.

Në lidhje me përdorimin e sistemit elektronik CAMS, janë dhënë disa sugjerime më sipër, siç është përmirësimi i tij në lidhje me shpërndarjen e drejtë të çështjeve ndërmjet prokurorëve si dhe përmirësime në drejtim të përshtatjes me ndryshimet e reja ligjore procedurale penale.

### ***Lufta kundër korrupsionit***

Pavarësisht ndryshimeve që kanë ndodhur në Prokurorinë tonë, duke u ngritur një Seksion i Posaçëm, me objekt kryesor luftën ndaj korrupsionit, pastrimit të produkteve të veprës penale etj. konstatohet se rastet e dërgimit për gjykim, specifiku ato të pastrimit të produkteve të veprës penale, mbeten të pakta. Duhet të kryhen përpjekje për të rritur luftën ndaj këtyre fenomeneve, por për këtë organi i akuzës, duhet domosdoshmërisht të ketë një ndihmë të madhe nga agjensitë e tjera ligjzbatuese, e kryesisht policia e shtetit. Mendojmë se në këtë drejtim, janë vërejtur mangësi të theksuara të oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve, të cilët vlerësojmë se kanë nevojë për trajnime. Pavarësisht pretendimeve të ngritura se ata trajnohen, mendimi jonë është që trajnimet duhet të jenë të përbashkëta si për prokurorët, gjyqtarët dhe oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve, pra të kryhen njëkohësisht dhe nga të njëjtët organizatorë.



Duhet të rritet gjithashtu besimi tek qytetarët që prokuroria është një institucion që mund të luftojë korrupsionin.

Megjithëse konstatohet ashpërsim i masave të sigurimit për veprat penale që lidhen me korrupsionin dhe abuzimin me detyrën, dënimet në lidhje me këto vepra penale kanë nevojë të rëndohen.

### ***Lufta kundër krimit të organizuar***

Në vitin 2019, duhet të merren masa të menjëhershme nga prokuroria jonë, për referimet e rasteve për kryerjen e hetimit pasuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, në respektim të ligjit nr. 10192 datë 03.12.2009 dhe Udhëzimin e Prokurorit të Përgjithshëm.

Përsa i përket veprave penale në fushën e lëndëve narkotike, përgjatë këtij viti ka pasur hetime të shumta por që përgjithësisht kanë qenë të kufizuara për mbajtës të lëndëve narkotike. Në këtë drejtim kërkohet një anagazhim më i madh i policisë gjyqësore dhe i agjentëve të tjerë ligjzbatues, në identifikimin e personave që janë pjesë e tregut të paligjshëm të shitjes së lëndëve narkotike apo armëve dhe një angazhim më i madh i prokurorëve për të shtrirë hetimin në disa drejtime, me qëllim, rritjen dhe forcimin e luftës ndaj narkotikëve apo armëve.

Masat shtrënguese si dhe dënimet, kanë pasur si orientim ashpërsimin e tyre dhe duhet te ecin po ne kete drejtim.

### ***Të drejtat e njeriut***

Në respektim të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në zbatim të parimit të mosdiskriminimit, pasur parasysh specifikisht të miturit dhe personat që për shkak të gjinisë janë vulnerabël, kemi parashtruar më sipër, në pjesën e parë të këtij raporti masat që janë marrë nga prokuroria jonë.

Zbatimi i hapave të ndërmarra nga kjo prokurori, ka gjetur mbështetje nga Prokurori i Përgjithshëm i cili është njoftuar në vazhdimësi për çdo hap të ndërmarrë.

Gjithashtu jemi munduar që t'u përgjigjemi kërkesave të qytetarëve apo subjekteve të ndryshme, në vazhdimësi qoftë në kuadrin e ligjit për të drejtën e informimit ashtu edhe në respektim të dispozitave procedurale penale.

Ka vend për përmirësim, sidomos në drejtim të trajnimit të punonjësve të zyrës së marrëdhënieve me publikun.

### ***Bashkëpunimi ndër institucional***

Pasur parasysh që askush nuk mund të luftojë i vetëm, një rëndësi e posaçme i është dhënë bashkëpunimit me agjensitë e tjerë ligjzbatuese. Vlen të përmendet bashkëpunimi me SHISH, pa anashkaluar faktin e bashkëpunimit me institucione të tjera si ILDKP, KLSH, DPPP, ZRPP apo

organet tatimore. Ky bashkëpunim nuk ka të bëjë vetëm me faktin e referimit prej tyre të veprave penale por edhe me faktin e shkëmbimit të informacionit në një mënyrë sa më të shpejtë. Në këtë drejtim, do të ishte me vend, mundësia e aksesimit në të dhënat e këtyre institucioneve nepermjet sistemeve të përbashkëta kompjuterike, pasi do të shkurtohte kohën e hetimit.

Është për t'u theksuar se ndjehet nevoja e referimit të veprave penale nga organet tatimore, pasi ndodh shpesh që veprat penale në fushën e tatim taksave referohen nga policia gjyqësore, kur ndërkohë fakti që të rezultojë penal, duhet të jenë ezauruar procedurat administrative, gjë që nuk ndodh në rastet e referuara nga policia.

Në këtë moment, vlen të theksojmë se në prokurori, nga policia gjyqësore referohen shpesh raste fatkeqe, të cilat që në momentin e parë konstatohen se nuk përmbajnë asnjë fakt penal (si vdekjet natyrale etj.), apo vepra penale që ndiqen drejtëpërdrejtë nga viktimat akuzuese në gjykatë, duke pasqyruar një rritje volumi të punës së prokurorisë.

Janë kryer analiza të përbashkëta vazhduese me Drejtorinë e Policisë Vendore Elbasan si dhe me Drejtorinë e Policisë së Shtetit, me qëllim marrjen e masave për dhënien jetë rasteve të dosjeve të pezulluara, apo studime të përbashkëta për veprat penale që konstatohen të jenë kryer me të njëjtin mekanizëm. Në këtë drejtim, mendoj se është e nevojshme rritja e bashkëpunimit me policinë gjyqësore dhe nënshtrimi i këtyre të fundit ndaj trajnimeve të vazhdueshme.

Siç theksuam edhe më lart, rezulton se bashkëpunimi në kuadrin e luftës ndaj dhunës me bazë gjinore, janë lidhur marrëveshjet e bashkëpunimit me institucionet e sipërshënuara, ku një ndër parashikimet e marrëveshjes është edhe shkëmbimi i statistikave. Në këtë drejtim, kërkohet mundësia e caktimit të një personi/punonjësi të prokurorisë që t'i dedikohet vetëm këtyre problemeve, pra mbledhjes së të dhënave statikore. Një gjë e tillë ka vlerë jo thjesht për qëllime studimi, por në këtë mënyrë mund të evidentohen rastet e riskut dhe marrja e masave parandaluese.

Në lidhje me veprat penale kundër mjedisit, është për t'u theksuar se qarku i Elbasanit, është i evidentuar si një qark me probleme të theksuara në ndotjen e ajrit. Në çështjet e kësaj kategorie, kërkojmë një angazhim më të madh të Ministrisë së Mjedisit, pasi prokuroria e ka të pamundur të gjejë mjete të cilat masin ndotjen e ajrit dhe angazhimi i ekspertëve privatë, përveç mungesës së këtyre mjeteve, për kryerjen e detyrave të cilat mund t'i realizojnë, janë një shpenzim shumë i madh për prokurorinë.

### ***Rekomandime***

Vlerësimi jonë është që për të mundësuar rritjen e efikasitetit në punë, ndjekjen e problematikave në dosje, të bëhet e mundur:

- Nxjerrja e udhëzimeve në lidhje me kushtet dhe kriteret që duhen mbajtur parasysh në rastet e zëvendësimit të prokurorit;
- Nxjerrja e udhëzimeve për rregullimin e marrëdhënieve Drejtues – Prokurore, në kuadrin e ushtrimit të ndjekjes penale për çështje të vecanta;

- Rritja e numrit të prokurorëve në varësi të statistikave të përgjithshme që ofrohen në lidhje me ngarkesën e tyre në punë;
- Rritja e numrit të punonjësve të administratës së prokurorisë, me qëllim ngarkimin me detyra të ndryshme siç është mbajtja e të dhënave statistikore etj. Aktualisht në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, statistikat mbahen nga Kancelarja e cila ushtron edhe një sërë detyrash të tjera.
- Përcaktimi me udhëzim të përgjithshëm i përjashtimit periodik nga shorti të Zëvendës drejtuesit, Prokurorit të Marrëdhënieve me publikun dhe mediat; Drejtuesve të Seksioneve. Aktualisht nga Drejtuesit e Prokurorive është proceduar herë pas here me përjashtim nga shorti për shkak të ngarkesës, por do të gjendej më me vend që ky përjashtim të parashikohej në mënyrë periodike apo me një përcaktim në përqindje të ngarkesës në punë.

Ndërkohë në një kuadër të përgjithshëm, mund të parashtrijmë se Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan ka ndërmarrë një tërësi masash për të bërë të mundur luftimin e kriminalitetit, qoftë nëpërmjet organizimeve në seksione, trajnimeve në të cilat prokurorët marrin pjesë, ngritjen e grupeve hetimore, bashkëpunimin me policinë gjyqësore të shërbimeve por edhe me të gjithë agjentët e tjerë ligjzatues; regjistrim të procedimeve penale kryesisht etj.

Megjithatë, ashtu si krimi nuk përfundon kurrë rrugën e vet, ashtu edhe puna e prokurorisë dhe policisë gjyqësore, nuk mund të përfundojë, por duhet të ecë me hapa më të shpejtë se sa krimi, me qëllim, bërjen të mundur zbardhjen e çështjeve dhe vënien para përgjegjësisë të autorëve të veprave penale.

## **DREJTUESI I PROKURORISË**

**ENKELEDA MILLONAI**